



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 418 Akti

Nr. 372 Vendimi  
Tiranë, më 22.4.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orianda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datat 21.4.2021 dhe 22.4.2021, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Rezarta Aliu (Paja), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, aktualisht gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016,** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015,** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012,** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu (Paja), e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- 1.** Znj. Rezarta Aliu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet (aktualisht gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës), bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
- 2.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni) është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor i përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Brunilda Bekteshi dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
- 3.** Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
- 4.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2018, ILDKPKI-ja ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu (Paja).
- 5.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2021, DSIK-ja vuri në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2021, të KDZH-së.
- 6.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2018, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2018, KLD-ja ka vënë në dispozicion raportin e analizimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu.
- 7.** Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjyqësor vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Rezarta Aliu, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesen e trupit gjyqësor, komisioneren Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
- 8.** Në datën 10.1.2020, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjyqësor, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk u shpreh mbi gjendje konflikti i interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjyqësor.

9. Me vendimin nr. 2, datë 8.4.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

10. Në datën 8.4.2021, trupi gjykues njoftoi, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 19.4.2021; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

11. Në datën 19.4.2021, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, dërgoi shpjegimet në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

12. Me vendimin nr. 3, datë 19.4.2021, trupi gjykues vendosi të njoftojë subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 21.4.2021, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

13. Në datën 21.4.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu (Paja), ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratën e pasurisë në datën 31.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu (Paja), është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009, me nr. indeksi \*\*\* dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private në vijim.

ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Rezarta Aliu, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarin të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit, referuar Vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni,

në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka hetuar të gjitha faktet dhe ka vlerësuar të gjitha rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, duke kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreu VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### **Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni kreu hetime në lidhje me pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, si vijojnë:**

**1. Tokë arë, “K. i P.”**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 4,000 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\*, dhe me sip. 4,000 m<sup>2</sup>, sipas LN, shkurt i vitit 1996, ndodhur në fshatin G., Elbasan. Vërtetim datë 23.1.2017, i ZVRPP-së Elbasan bashkëlidhur AMTP-së, datë 10.11.1991, në emër të shtetasit N. P.. Vlera: 888,000 lekë, llogaritur sipas VKM-së Nr. \*\*\*, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP-së + 1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

Gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet verifikuese në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, bazuar në dokumentet shkresore<sup>1</sup>, sipas të cilave u vërtetua se:

**1.1.** Me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 10.11.1991, shtetasit N. H. P. (vëllai i subjektit nga babai) i është dhënë tokë me sip. 4.000 m<sup>2</sup> në fshatin G., në përbërjen familjare të të cilit në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”, kanë qenë 8 persona, një prej të cilëve subjekti i rivlerësimit, vërtetuar me certifikatë familjare, lëshuar në datën 25.1.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh.

**1.2.** ZVRPP-ja Elbasan konfirmoi regjistrimin e pasurisë të llojit “arë”, me nr. \*\*\*, me sip. 4,000 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\*, dhe me sip. 4,000 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, në G., Elbasan, në pronësi të shtetasit N. H. P., si përfaqësues i familjes bujqësore. Subjekti nuk e ka deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri në DPFĐ-në e vitit 2009, ndërkohë që e ka deklaruar saktësisht në DPV-në e vitin 2016<sup>2</sup> dhe në deklaratën *Vetting*.

<sup>1</sup> Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* dhe aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK-ja Elbasan, në dosjen e Komisionit.

<sup>2</sup> Gjatë plotësimit të kësaj deklarate për shkak të plotësimit në kompjuter, në kutinë përkatëse nuk është shfaqur emri i përfaqësuesit të familjes bujqësore N. P..

**1.3.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, pas vdekjes së shtetasit H. P. (babi i subjektit) në datën 30.11.2000, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është subjekti i rivlerësimit, e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, pra 1/7 pjesë të 1/8 pjesë të pasurisë objekt shqyrtimi.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mosdeklarimin e pjesës takuese në bashkëpronësi të pasurisë nr. \*\*\*, në DPV-në e vitit 2009, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar. Në parashtrimet e datës 19.4.2021, subjekti deklaroi se shkak i mosdeklarimit ka qenë se kjo pasuri i ishte dhënë më vete vëllait të saj nga babai, shtetasit N. P., në kohën kur ajo ishte vetëm 10 vjeç dhe se ka ardhur në dijeni të kësaj AMTP-je në janar të vitit 2017 në kuadër të mbledhjes së dokumentacionit për procesin e rivlerësimit. Më tej, subjekti ka sqaruar se ka deklaruar në DPV-në e vitit 2009 pasuritë e paluajtshme të përfituara me ligjin nr. 7501 nga babai i saj H. P. me AMTP-në e datës 15.11.1991, ndërkohë që vëllai N. P. në vitin 2009 nuk ishte pjesë përbërëse e familjes, por ka qenë në familje më vete dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur detyrimin e deklarimit.

Referuar përbërjes familjare të vitit 2009, në të cilën shtetasi N. P. nuk rezulton të ketë qenë pjesë përbërëse<sup>3</sup>, në konsideratë të nenit 21 të ligjit nr. 9049/2003<sup>4</sup>, në procesin e vendimmarrjes, Komisioni i vlerësoi bindëse dhe të bazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

**2. Tokë arë, “Toka e re”**, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 16,000 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\*, dhe me sip. 14,425 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, ndodhur në fshatin G., Elbasan. Vërtetim datë 23.1.2017, i ZVRPP-së Elbasan, bashkëlidhur AMTP-ja, datë 15.11.1991, në emër të shtetasit H. P.. Vlera: 3,552,000 lekë për sip. 16,000 m<sup>2</sup> dhe 3,202,350 lekë për sip. 14,425 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së Nr. 89, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP-së + 1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).

## **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

Gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet verifikuese në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie bazuar në dokumentet shkresore<sup>5</sup>, sipas të cilave u vërtetua se:

**2.1.** Me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H. M. P. (babai i subjektit) i është dhënë në pronësi tokë, gjithsej me sip. 30,500 m<sup>2</sup>, në fshatin G., Elbasan, nga e cila parcela “Toka e re” me sip. 16,000 m<sup>2</sup>. Në përbërjen e tij familjare, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, kanë qenë 8 persona, një prej të cilëve subjekti i rivlerësimit, vërtetuar me certifikatë familjare, lëshuar në datën 25.1.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh.

**2.2.** Sipas vërtetimit, datë 23.1.2017, të ZVRPP-së Elbasan, vërtetohet regjistrimi i kësaj pasurie në emër të shtetasit H. M. P., si përfaqësues i familjes bujqësore, si pasuria e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, me sip. 16,000 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe me sip. 14,425 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, e ndodhur në z. k. \*\*\*, fshati G., Elbasan.

**2.3.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, pas vdekjes së shtetasit H. P. në datën 30.11.2000, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është

<sup>3</sup> Shihni përbërjen familjare të subjektit në DPV-në e vitit 2009 dhe certifikatën familjare të gjendjes familjare për vitin 2007 ku shtetasi N. P. nuk ka qenë pjesë e saj.

<sup>4</sup> Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore), burimet e krijimit dhe detyrimet financiare të subjektit.

<sup>5</sup> Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK-ja Elbasan, në dosjen e Komisionit.

subjekti i rivlerësimit, e cila trashëgon 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, pra 1/7 pjesë të 1/8 pjesë të pasurisë objekt shqyrtimi.

**2.4.** ASHK-ja Elbasan ka informuar se znj. Rezarta H. Aliu (Paja) ka në bashkëpronësi me shtetasit H. H. P., N. H. P., F. H. T., M. H. P., E. H. Ll. dhe B. H. P. pasurinë e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, G..

**2.5.** Subjekti e ka deklaruar saktësisht këtë pasuri në DPFĐ-në e vitit 2009 dhe në DPV-në e vitit 2016.

**3. Tokë arë, “K. i P.”**, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 11,750 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe sip. 13,295 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, ndodhur në fshatin G., Elbasan. Vërtetim datë 23.1.2017, i ZVRPP-së Elbasan, bashkëlidhur AMTP-së datë 15.11.1991, në emër të shtetasit H. P.. Vlera: 2,608,500 lekë për sip. 11,750 m<sup>2</sup> dhe 2,951,490 lekë për sip. 13,295 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së Nr. \*\*\*, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP-së + 1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

Gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet verifikuese në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie bazuar në dokumentet shkresore<sup>6</sup>, nga të cilat rezultoi se:

**3.1.** Me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H. M. P. (babai i subjektit) i është dhënë në pronësi tokë, gjithsej me sip. 30,500 m<sup>2</sup>, në fshatin G., nga e cila parcela “K. i P.” me sip. 12,000 m<sup>2</sup>. Në përbërjen e tij familjare, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”, kanë qenë 8 persona, një prej të cilëve subjekti i rivlerësimit, vërtetuar me certifikatë familjare, lëshuar në datën 25.1.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh.

**3.2.** Sipas vërtetimit, datë 23.1.2017, të ZVRPP-së Elbasan, vërtetohet se në pronësi të shtetasit H. M. P., si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, me sip. 11,750 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe sip. 13,295 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, e ndodhur në z. k. \*\*\*, fshati G., Elbasan.

**3.3.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, pas vdekjes së shtetasit H. P. në datën 30.11.2000, janë përcaktuar 7 trashëgimtarët ligjorë të tij, midis të cilëve subjekti i rivlerësimit, të cilët trashëgojnë 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, pra 1/7 pjesë të 1/8 pjesë të pasurisë objekt shqyrtimi.

**3.4.** ASHK-ja Elbasan ka informuar se znj. R. H. A. (P.) ka në bashkëpronësi me shtetasit H. H. P., N. H. P., F. H. T., M. H. P., E. H. Ll. dhe B. H. P. pasurinë e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, G..

**3.5.** Subjekti e ka deklaruar saktësisht këtë pasuri në DPFĐ-në e vitit 2009 dhe në DPV-në e vitit 2016, sipas detyrimit të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

**4. Tokë arë, “K. i P.”**, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 2,070 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, ndodhur në fshatin G., Elbasan (pasuritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* i korrespondojnë pasurisë nr. \*\*\* të AMTP-së nr. \*\*\*, sipërfaqja është pasqyruar në pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*). Vërtetim datë 23.1.2017, i ZVRPP-së Elbasan bashkëlidhur AMTP-së, datë 15.11.1991, në emër të shtetasit H. P.. Vlera: 459,540 lekë për sip. 2,070 m<sup>2</sup>. Llogaritur sipas VKM-së Nr. 89, datë 3.2.2016. Pjesa takuese: 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP-së + 1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi).

<sup>6</sup> Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK-ja Elbasan, në dosjen e Komisionit.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

Gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet verifikuese në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie bazuar në dokumentet shkresore<sup>7</sup>, nga të cilat rezultoi se:

**4.1.** Me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H. M. P. (babai i subjektit) i është dhënë në pronësi tokë, gjithsej me sip. 30,500 m<sup>2</sup>, në fshatin G., nga e cila ngastra nr. \*\*\*, me vendndodhje “K. i P.”, me sip. 12,000 m<sup>2</sup>. Në përbërjen e tij familjare, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501 kanë qenë 8 persona, një prej të cilëve subjekti i rivlerësimit, vërtetuar me certifikatë familjare, lëshuar në datën 25.1.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh.

**4.2.** Sipas vërtetimit, datë 23.1.2017, të ZVRPP-së Elbasan vërtetohet se në pronësi të shtetasit H. M. P., si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, me sip. 2,070 m<sup>2</sup> sipas LN, shkurt i vitit 1996, ndodhur në z. k. \*\*\*, fshati G., Elbasan (pasuritë nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* i korrespondojnë pasurisë nr. \*\*\* të Aktit nr. \*\*\*. Sipërfaqja është pasqyruar në pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*).

**4.3.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, pas vdekjes së shtetasit H. P. në datën 30.11.2000, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është edhe subjekti i rivlerësimit, të cilët trashëgojnë secili me nga 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, pra 1/7 pjesë të 1/8 pjesë të pasurisë objekt shqyrtimi.

**4.4.** ASHK-ja Elbasan ka informuar se znj. Rezarta H. Aliu (Paja) ka në bashkëpronësi me shtetasit H. H. P., N. H. P., F. H. T., M. H. P., E. H. Ll. dhe B. H. P. pasurinë e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, G..

**4.5.** Subjekti e ka deklaruar saktësisht këtë pasuri në DPFD-në e vitit 2009 dhe në DPV-në e vitit 2016, sipas detyrimit të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ, për sa i takon pasurive të llojit “tokë arë”, përshtuar si më sipër, u konstatua se:

i) Pavarësisht se subjekti ka deklaruar një vlerë të pasurive “tokë arë”, llogaritur sipas VKM-së Nr. 89, datë 3.2.2016, për përfitimin e tyre nuk është shpenzuar asnjë vlerë monetare, pasi sipas deklarimeve të subjektit, të cilat përputhen plotësisht me dokumentet e administruara, pasuritë janë përfituar sipas AMTP-së përkatëse të vitit 1991, sipas ligjit nr. 7501, “Për tokën”. Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan problematika dhe dyshime në lidhje me këto pasuri.

ii) Mbi këto pasuri të llojit “tokë arë” nuk u vërtetua të jenë kryer investime. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se këto pasuri janë përdorur nga familja e saj për prodhime bujqësore dhe blegtorale të ndryshme për jetesë, si dhe për shitje me pakicë apo shumicë, në varësi të llojit të produktit dhe sasisë së prodhimit. Subjekti ka sqaruar se pas vdekjes së babait H. P. në vitin 2000, familja e saj hoqi dorë nga blegtoria dhe iu përkushtua prodhimit të produkteve të ndryshme bujqësore për vete dhe për shitje, sidomos duhanit, si bimë industriale që prodhohet me shumicë në zonën e Belshit, nga i cili nxirren të ardhura të mjaftueshme për të jetuar. Në lidhje me investimet e kryera, subjekti ka deklaruar se mbi tokat bujqësore nuk është kryer ndonjë investim, por thjesht janë shfrytëzuar në mënyrë të përvitshme, ndërkohë që në datën 25.1.2021, vëllai i saj B. P. ka aplikuar në AZHBR si fermer për përfitimin e grantit që subvencionohet nga BE-ja për kultivimin e drurëve frutorë. Në lidhje me pagesat e taksës bujqësore, subjekti ka deklaruar se ato janë paguar deri në vitin 2021, sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Belsh. Ndërsa, për sa i takon pagesave të sigurimeve

<sup>7</sup> Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK-ja Elbasan, në dosjen e Komisionit.

shoqërore, subjekti ka sqaruar se vetëm nëna e saj ka paguar kontributet si e vetëpunësuar në bujqësi një vit, 1994 - 1995, për plotësimin e vjetërsisë në punë dhe përfitimin e pensionit të pjesshëm të pleqërisë.

Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumentet, si vijon:

- dokumentacion mbi aplikimin e vëllait B. P. si fermer në AZHBR;
- vërtetim nr. \*\*\*, datë 21.1.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Financës, Bashkia Belsh, mbi shlyerjen e taksës së tokës deri në vitin 2021;
- vërtetim, datë 20.1.2021, “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, znj. H. P., lëshuar nga DRSSH-ja Elbasan;
- shkresë, datë 20.1.2021, e Bashkisë Belsh, sipas të cilës vërtetohet se të ardhurat vjetore nga tokat bujqësore janë në shumën 363,512 lekë.

**5. Tokë truall**, pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 250 m<sup>2</sup>, nga ku ndërtesë me sip. 145 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin G., Elbasan. Vlera: 86,250 lekë për truall me sip. 250 m<sup>2</sup>, llogaritur sipas VKM-së Nr. 89, datë 3.2.2016 dhe 50,750 lekë ndërtimi me sip. 145 m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 1/7 (1/8 pjesë në bazë të AMTP-së + 1/7 e 1/8 pjesë me trashëgimi truall + banesë).

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

Gjatë hetimit administrativ u kryen veprimet verifikuese në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie bazuar në dokumentet shkresore<sup>8</sup>, sipas të cilave u vërtetua se:

**5.1.** Me AMTP-në e datës 15.11.1991, shtetasit H. M. P. (babai i subjektit) i jepet në pronësi tokë, gjithsej me sip. 30,500 m<sup>2</sup>, në fshatin G., në përbërjen familjare të të cilit, në momentin e përfitimit të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501, kanë qenë 8 persona, një prej të cilëve subjekti i rivlerësimit, vërtetuar me certifikatë familjare, lëshuar në datën 25.1.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh.

**5.2.** Sipas vërtetimit, datë 23.1.2017, të ZVRPP-së Elbasan, vërtetohet se në pronësi të shtetasit H. M. P., si përfaqësues i familjes bujqësore, figuron e regjistruar pasuria e llojit “arë”, me nr. \*\*\*, me sip. 250 m<sup>2</sup>, nga ku ndërtesë me sip. 145 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k. \*\*\*, fshati G., Elbasan.

**5.3.** Me dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 20.3.2017, pas vdekjes së shtetasit H. P. në datën 30.11.2000, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të tij, një prej të cilëve është edhe subjekti i rivlerësimit, të cilët trashëgojnë secili me nga 1/7 pjesë të pasurisë trashëgimore, pra 1/7 pjesë të 1/8 pjesë të pasurisë objekt shqyrtimi.

**5.4.** ASHK-ja Elbasan ka informuar se znj. Rezarta H. Aliu (Paja) ka në bashkëpronësi me shtetasit H. H. P., etj., pasurinë e llojit “truall”, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, G.. Nga kartela e pasurisë konstatohet se në rubrikën “sipërfaqe totale e pasurisë” pasqyrohet 250 m<sup>2</sup>, Ref. Akti nr. \*\*\* dhe 145 m<sup>2</sup> ndërtesë.

**5.5.** Nga verifikimi i deklarimeve ndër vite rezulton se subjekti ka kryer deklarime për këtë pasuri në DPDFD-në e vitit 2009 dhe në DPV-në e vitit 2016.

Bazuar në sa më sipër, deklaratimet e subjektit përputhen plotësisht me dokumentet e administruara dhe në lidhje me këtë pasuri nuk u evidentuan dyshime dhe problematika.

<sup>8</sup> Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2020, nga ASHK-ja Elbasan, në dosjen e Komisionit.



## **5.6. Lidhur me vlerën e pasurisë dhe investimeve të mundshme të subjektit mbi pasurinë, u konstatua se:**

Subjekti ka deklaruar si vlerë të pasurisë shumë prej 86,250 lekësh për truallin dhe shumë prej 50,750 lekësh për ndërtimin me sip. 145 m<sup>2</sup>, duke iu referuar VKM-së Nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, vendim i cili përcakton vlerat e tokës bujqësore dhe jo koston e ndërtimit të banesave mbi to, dhe si i tillë, nuk mund të shërbejë si bazë për përcaktimin e vlerës së objekteve të ndërtuara.

Me qëllim evidentimin e vitit të ndërtimit dhe përlllogaritjes së vlerës reale të objektit, si dhe faktit nëse subjekti ka investuar në këtë pasuri, subjektit iu kërkua informacion, e cila në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se ndërtimi i shtëpisë njëkatëshe me tri dhoma ka nisur pas martesës së prindërve të saj, rreth viteve 1975 - 1977 dhe është bërë me punë vullnetare të babait, vëllait të tij dhe nipërve. Po kështu, subjekti ka informuar se ka aplikuar për informacion në DPA për një kopje të lejes së ndërtimit në atë periudhë, por nuk ka marrë përgjigje.

Në lidhje me përdorimin e kësaj banese ndër vite, subjekti ka deklaruar se *në këtë shtëpi nga viti 1977 e në vijim ka jetuar familja e saj, gjyshja nga babai, prindërit e saj, si dhe fëmijët e tyre. Konkretisht, vëllai nga babai, N. P., vazhdon të jetojë aktualisht familjarisht; F. P. deri në vitin 2006; M. P. përveç emigracionit deri në vitin 2012 pastaj e përdor vetëm në sezon prodhimesh bujqësore; Rezarta Paja deri në vitin 2006; E. P. deri në vitin 2006; dhe B. P. deri në vitin 2012, më pas e përdor vetëm me raste (në sezon prodhimesh bujqësore). Po kështu, edhe pse janë shkëputur që nga viti 2012, nëna e saj H. P. dhe dy vëllezërit, M. dhe B. P., vazhdojnë e përdorin këtë shtëpi kur kultivojnë tokën bujqësore në sezone të caktuara.*

Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore, si vijon:

- 3 foto të shtëpisë njëkatëshe me tjegulla, në të cilat duket se banesa është ndërtuar herët;
- certifikatë familjare lëshuar në datën 13.1.2021, nga Zyra e Gjendjes Civile Belsh, e cila vërteton gjendjen familjare prej 8 personash, të datës 1.8.1991, të cilët logjikisht kanë banuar në pasurinë objekt shqyrtimi në vitin 1991;
- praktikën e pensionit të pleqërisë të shtetasit H. P. dhe vërtetimin për vjetërsinë në punë për efekt pensioni të shtetasës H. P. me nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2021, lëshuar nga DRSSH-ja Elbasan, e cila tregon se kjo shtetase ka punuar në kooperativën bujqësore Sh. të fshatit G., në vitet 1975 – 1991;
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 5.2.2021, lëshuar nga kryetari i fshatit G., z. K. T., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit lidhur me kohën e ndërtimit të banesës dhe përdorimin e saj nga anëtarët e familjes;
- formular aplikimi në DPA për marrje informacioni për banesën në G.;
- ndërsa në parashtrimet e datës 19.4.2021, subjekti ka paraqitur dokumente që provojnë se të gjithë fëmijët e familjes kanë kryer studimet në shkollën e mesme bujqësore C., Elbasan, nga viti 1990 e në vijim<sup>9</sup>.

Përveç sa më sipër, me qëllim marrjen e një informacioni në lidhje me përdorimin e pasurisë, me kërkesë të Komisionit, FSHU-ja<sup>10</sup> informoi se shtetasja H. P., nëna e subjektit, ka lidhur kontratën nr. \*\*\*, B., Elbasan, duke vënë në dispozicion informacion mbi pagesat e shpenzimit të energjisë elektrike që prej vitit 2008, periudhe gjatë se cilës subjekti vazhdonte studimet në shkollën e magistratures dhe që vazhdojnë deri në vitin 2021, fakt që tregon vijimësinë e

<sup>9</sup> Znj. F. P. ka studiuar në këtë shkollë në vitet 1990 - 1994; z. M. P. në vitet 1993 – 1995; z. B. P. ka kryer studimet e larta për Inxhinieri Agrare, në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitet 2013 - 2019.

<sup>10</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2020, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

përdorimit të kësaj banese, e cila sipas subjektit sot banohet prej vëllait të saj nga babai, shtetasit N. P..

Në përfundim të hetimit administrativ, pavarësisht se nuk u vërtetua viti i ndërtimit dhe kostoja e objektit, bazuar në deklaratimet e subjektit dhe provat e administruara, Komisioni krijoi bindjen se banesa në fshatin G., Elbasan, është ndërtuar dhe përdorur në një periudhë të hershme (me gjasa para lindjes së subjektit) nga familja e origjinës së subjektit nga babai, ndërsa znj. Rezarta Aliu ka banuar në të me familjen deri në vitin 2006, kur është larguar për të ndjekur studimet e magjistraturës në Tiranë. Për rrjedhojë, nuk u vërtetuan investime të kryera nga subjekti mbi këtë pasuri.

**6. Automjet i tipit “Mercedes-Benz \*\*\*\*”,** prodhim i vitit 2001, me targa \*\*\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.4.2016, me të ardhurat e siguruara nga kredia bankare, datë 23.3.2016, nga “Raiffeisen Bank” sh.a., me blerës E. R. A. dhe Rezarta H. Aliu. Vlera: 4,000 euro. Pjesa takuese: 1/2 me bashkëshortin.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**6.1.** DPSHTRr-ja<sup>11</sup> ka konfirmuar se znj. Rezarta H. Aliu ka të regjistruar automjetin me targa \*\*\*\*, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.4.2016, në vlerën 4,000 euro nga shtetasja M. D., e cila kishte paguar doganën në datën 14.4.2016. Kjo pasuri është deklaruar saktësisht në DPV-në e vitit 2016 me të njëjtin burim krijimi të deklaruar edhe në deklaratën *Vetting* “të ardhurat e siguruara nga kredia bankare e datës 23.3.2016”.

### **6.2. Për sa i takon kredisë së deklaruar si burim, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:**

- Me anë të kontratës së kredisë bankare të datës 23.3.2016<sup>12</sup>, shtetasit Rezarta Aliu dhe E. A. kanë marrë nga “Raiffeisen Bank” kredi në shumën 1,200,000 lekë, me qëllim përdorimin për arsye personale, me afat 36 muaj, disbursuar në datën 25.3.2016.

- Në DPV-në e vitit 2016, në rubrikën “detyrime financiare” subjekti ka deklaruar se ka marrë një kredi në shumën 1,200,000 lekë në datën 23.3.2016, për arsye personale, duke listuar: shlyerje të kredive të mëparshme; blerje automjeti; si dhe pagesë pakete turistike. Kjo kredi është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2017, duke përcaktuar shumat e detyrimit të shlyer dhe të mbetur.

- Nga lëvizjet e llogarisë së “Raiffeisen Bank” rezulton se shuma prej 1,200,000 lekësh është disbursuar në llogarinë e subjektit në datën 25.3.2016 dhe në të njëjtën datë janë mbyllur dy kredi të mëparshme në këtë bankë, duke u paguar shuma në total prej 452,853.35 lekësh. Ndërsa, shuma e mbetur prej 700,736 lekësh është tërhequr *cash* në datën 26 deri më 29.3.2016. Kjo shumë e tërhequr e mbulon tërësisht vlerën 4,000 euro të automjetit të paguar në datën 16.4.2016 dhe vlerën 840 euro të paketës turistike të paguar në datën 14.6.2016.

Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, u vërtetua burimi i ligjshëm i të ardhurave dhe nuk rezultuan dyshime apo problematika.

**7. Automjet i tipit “Mercedes-Benz \*\*\*\*”,** prodhim i vitit 1993, me targa \*\*\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, me të ardhurat e siguruara nga paga, me blerës E. A.. Vlera: 140,000 lekë. Pjesa takuese: 1/2 me bashkëshortin.

<sup>11</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, nga DPSHTRr-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>12</sup> Shihni kontratën në aktet e aneksit nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**7.1.** DPSHTRR-ja<sup>13</sup> ka konfirmuar se shtetasi E. A. ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, i cili fillimisht ka pasur targën \*\*\*, i blerë me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, nga shtetasi Gj. T., në vlerën 140,000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në DPV-në e vitit 2016 me të njëjtin burim krijimi të deklaruar edhe në deklaratën *Vetting* “të ardhurat e siguruara nga paga”.

**7.2.** Për sa i takon pagesës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, nga lëvizjet e llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, rezulton se në datën 21.10.2016, 10 ditë më vonë se redaktimi i kontratës së shitjes<sup>14</sup>, është transferuar shuma 140,300 lekë, me përshkrimin “pagesë për blerje automjeti \*\*\*” dhe përfitues është shtetasja M. D.. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi relatat me këtë shtetase dhe arsyet e kalimit të çmimit të blerjes në llogari të saj, subjekti ka sqaruar se<sup>15</sup> shtetasja M. D. është bashkëshortja e shitësit të automjetit, z. Gj. T.. Për të vërtetuar këtë pretendim subjekti ka paraqitur si prova shkresore: (i) certifikatë martesë nr. \*\*\*, datë 18.2.2021; (ii) certifikatë familjare nr. \*\*\*, datë 18.2.2021; si dhe (iii) certifikatë personale nr. \*\*\*, datë 23.2.202, nga të cilat rezulton se shtetasja M. T. është bashkëshortja e shtetasit Gj. T.. Nga verifikimi në sistemin e gjendjes civile, mbiemri i vajzërisë së shtetasës M. T. ka qenë D.. Deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e administruar.

Pas verifikimeve nuk kanë rezultuar procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë shtetasen M. D.<sup>16</sup> apo procedime penale të regjistruara në emër të saj<sup>17</sup>.

**7.3. Në lidhje me burimin e krijimit**, nga analiza financiare si në tabelën vijuese, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në datën 21.10.2016.

Përshkrimi	Datë 21.10.2016
<b>Pasuritë</b>	<b>824 688</b>
Automjet tip “Daimler Chrysler”	540 920
Automjet tip “Mercedes-Benz”	140 000
<b>Shtesa/pakësime/ likuiditeteve</b>	<b>143 768</b>
Gjendja e likuiditeteve	223 167
<b>Të ardhurat</b>	<b>3 113 077</b>
Paga e subjektit (pa dietat)	989,470
Paga e bashkëshortit	785 340
Kredi bankare 1,200,000 lekë në “Raiffeisen Bank”	1 200 000
Interesa bankare	3 267
Nga shitja e automjet tip “Mercedes-Benz” (bashkëshorti) <sup>18</sup>	135 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>1 742 987</b>
Shpenzime jetike	587 730

<sup>13</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>14</sup> Kontrata e shitjes përcakton që çmimi i shitjes do të likuidohet nëpërmjet bankës, pa përcaktuar afat.

<sup>15</sup> Shihni përgjigjet e pyetjeve të datës 17.2.2021, në dosjen e Komisionit.

<sup>16</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>17</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

<sup>18</sup> Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar shitjen nga bashkëshorti të këtij automjeti për pjesë këmbimi, verifikuar të jetë kryer me shkresë të thjeshtë, pa noter, në datën 12.10.2016 (shihni aneksi nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së). Ky automjet është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në DPV/2013 si i blerë në vitin 2008, para martesës, në shumën 5,500 euro, fakt i evidentuar me kontratën e shitblerjes që ndodhet në aneksin nr. \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

Shpenzime udhëtimi	170 743
Shpenzime transporti	74 000
Shlyerje këste kredie 500,000 lekë “Raiffeisen Bank”	395 036
Shlyerje këste kredie 45,990 lekë “Raiffeisen Bank”	42 387
Shlyerje këste kredie 55,990 lekë	58 387
Shlyerje këste kredie 1,200,000 lekë “Raiffeisen Bank”	213 153
Shlyer këste kredie 76,800 lekë UB	67 498
Blerje celulari	84 053
Shpenzime/komisione për kreditë	20 000
Shpenzime qiraje, janar (pyetësori standard)	30 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>545 402</b>

Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, e cila u vërtetua të jetë blerë me të ardhura të ligjshme, nuk rezultuan dyshime apo problematika.

**8. Kontratë depozite bankare, datë 5.8.2015, në shumën 220,000 lekë,** në BKT, e vendosur si garanci e kredisë bankare të lehtësuar për blerje apartamenti, me nr. \*\*\*, datë 19.9.2012. Gjendja në datën 23.1.2017 është në shumën 223,267.20 lekë, ku përfshihen interesat vjetore të vitit 2016. Burimi: kursime bashkëshortore, viti 2014. Pjesa takuese: 1/2.

#### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë depozitë**

**8.1.** BKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2020, ka konfirmuar këtë depozitë sipas deklarimeve të subjektit. Në lidhje me krijimin saj, nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>19</sup> konstatohet se është hapur sipas kontratës së depozitës bankare të datës 5.8.2015, me afat 1-vjeçar, në shumën 220,000 lekë dhe është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2015. Ndërsa, me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, lëshuar nga BKT-ja, vërtetohet se znj. Rezarta H. Aliu ka depozitë nr. \*\*\* në BKT, me gjendje në datën 23.1.2017, në shumën 223,267.20 lekë.

**8.2.** Si burim për krijimin e kësaj depozite ka shërbyer shuma prej 530,127.41 lekësh (përfshirë interesat) e transferuar nga shtetasi S. M. te subjekti në llogarinë në BKT, në datën 5.8.2015. Në të njëjtën datë, shuma prej 220,000 lekësh është investuar në depozitë me afat 1-vjeçar dhe është vendosur si garanci për kredinë e marrë në shumën 4,950,000 lekë, sipas marrëveshjes siguroese me bllokim shume, me nr. \*\*\*, datë 8.9.2015, të nënshkruar midis BKT-së dhe znj. Rezarta Aliu, si dhe z. E. A., në cilësinë e dorëzanësit (depozita e z. S. M. është trajtuar në vijim).

#### **Detyrime financiare**

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar detyrimet financiare, si vijojnë:

**1. Kontratë kredie bankare e lehtësuar** nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, për blerje apartamenti nga shtetasja H. P., në shumën 4,950,000 lekë, interesi 3 % në vit, me afat 30 vjet, për periudhën 15.11.2012 – 2042, kësti mujor 21,000 lekë/muaj, e ndryshuar me aneks kontratën me nr. \*\*\*, datë 8.9.2015, ku zëvendësohet dorëzanësi S. M. nga E. A. dhe Rezarta Aliu, që sigurojnë këtë kredi me depozitën prej 220,000 lekësh. Shuma e detyrimit financiar të mbetur pa shlyer është 4,494,095.18 lekë.

#### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë kredi dhe apartamentin që është blerë nëpërmjet saj**

<sup>19</sup>Shihni aktet në aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

Duke qenë se subjekti ka qenë bashkëkredimarrëse në këtë kredi, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e një apartamenti banimi nga nëna e saj dhe në kushtet kur ka deklaruar rregullisht shlyerjet e kësteve të kredisë dhe shumat e detyrimeve të mbetura, Komisioni ka kryer hetime të thelluara, me qëllim vërtetimin e deklarimeve të subjektit, lidhjeve të saj me këtë pasuri, si dhe heqjen e çdo dyshimi që kjo pasuri mund të jetë një pasuri e subjektit të rivlerësimit.

**1.1. Për sa i takon procedurave të marrjes së kredisë dhe deklarimeve të subjektit** në lidhje me këtë kredi, gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosjen e ILDKPKI-së<sup>20</sup>, dokumentet e BKT-së<sup>21</sup>, si dhe nga deklaratimet e subjektit në DPV dhe gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka evidentuar faktet dhe rrethanat, si vijojnë:

**1.1.1.** Me kontratën e kredisë bankare nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, me palë kredihënëse BKT, palë kredimarrëse H. P. (nëna e subjektit) dhe subjekti Rezarta Paja, me dorëzanës shtetasit M. P. dhe B. P., (vëllezërit e subjektit), K. C. dhe E. C. (shitës të pasurisë që është vënë si garanci për kredinë, shitur nënës së subjektit H. P.), si dhe shtetasi S. M., kredimarrësit kanë marrë në BKT kredi në shumën 4,950,000 lekë. Kjo kredi është dhënë bazuar në: ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit për banorët e zonave urbane”; VKM-në Nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”; udhëzimit nr. \*\*\*, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; si dhe marrëveshjes tripalëshe datë 18.2.2009.

**1.1.2.** Në DPV-në e vitit 2012, subjekti Rezarta Paja ka deklaruar: *“Kredi bankare e lehtësuar për blerje apartamenti në Y., në shumën 4,950,000 lekë, me 3 % në vit, me afat 30 vjet, me kësht mujor 21,000 lekë në muaj. Fillon më 15.11.2012 dhe përfundon më 15.11.2041. Shuma e shlyer 42,000 lekë. Detyrimi i mbetur 4,936,043.31 lekë”*. Ndërsa në DPV-të e viteve 2013 – 2016 ka deklaruar rregullisht shumat përkatëse të shlyerjes me këste të kredisë, si dhe detyrimet e mbetura.

**1.1.3.** Sipas aneksit të çeljes dhe përdorimit të kredisë, të datës 19.9.2012, kreditimi do të përdoret nga kredimarrësi për blerje banese. Ndërsa, sipas aneksit të elementëve specifikë të kredisë të datës 19.9.2012, shuma e kredisë prej 4,950,000 lekësh do të përdoret për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit në pronësi të shtetasve K. dhe E. C. dhe shuma e disbursuar do të transferohet nga llogaria e kredisë, në favor të shitësve të objektit të kredituar K. C. dhe E. C., me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së.

**1.1.4.** Për marrjen e kësaj kredie janë vendosur si garanci pasuritë: (1) apartament me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, e regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. pasurie \*\*\*, Y., Tiranë, e regjistruar në emër të shtetasit K. C.; si dhe (2) depozitë bankare me nr. \*\*\*, me titullar S. M., në shumën totale prej 500,000 lekësh, në degën e BKT-së, “M. Sh.”.

**1.1.5.** Sipas aneks-kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 8.9.2015, shtetasi E. A. (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar se ofrohet dorëzanës për të siguruar kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, dhe garancia e vendosur nga z. S. M.<sup>22</sup> zëvendësohet me depozitën prej 220,000 lekësh në emër të znj. Rezarta Aliu (Paja).

Për sa me sipër, nuk janë evidentuar problematika gjatë përmbushjes së procedurave ligjore për dhënien e kredisë dhe se subjekti ka kryer deklaratime të saka lidhur me këtë kredi për periudhën 2012 – 2016.

<sup>20</sup>Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>21</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, nga BKT-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur, në dosjen e Komisionit.

<sup>22</sup>Sipas lëvizjeve të llogarisë së BKT-së rezulton se në datën 5.8.2015 shuma prej 530,127.41 lekësh është transferuar nga llogaria e S. M. në llogarinë e subjektit.

## **1.2. Për sa i takon përmbushjes së kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë së butë, Komisioni kreu veprimet hetimore, si vijojnë:**

**1.2.1.** U kërkua informacion nga BKT-ja, e cila vuri në dispozicion dosjen e plotë të kredisë në shumën 4,950,000 lekë<sup>23</sup>, nga verifikimi i dokumentacionit të së cilës konstatohet se: (i) aplikimi për kredi për shtëpi në BKT është bërë nga shtetasja H. P. (e papunë) në datën 23.6.2012; (ii) znj. Rezarta Paja ka plotësuar në datën 23.6.2012 formularin e dorëzuesit të bashku me dy vëllezërit e saj B. P. dhe M. P.; (iii) përbërja familjare e shtetasës H. P. në datën e aplikimit të kredisë, 26.4.2014, ka qenë H. P., M. P., Rezarta Paja dhe B. P..

**1.2.2.** U pyet subjekti i rivlerësimit mbi përmbushjen e kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë dhe dokumentacionin përkatës, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nga nëna e saj H. P. janë përmbushur kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin Nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar. Sipas saj, në emër të anëtarëve të familjes së shtetasës H. P. nuk ka pasur asnjë pronë të regjistruar, ata nuk ushtronin veprimtari ekonomike, nuk kanë qenë subjekt i taksës së vlerës së shtuar, si dhe të ardhurat mujore familjare i kanë pasur në shumën 76,500 lekë.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur praktikën e plotë të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese nga Bashkia Tiranë dhe BKT<sup>24</sup>, nga ku konstatohet se:

i) znj. H. P. dhe fëmijët e saj M. P., Rezarta Paja dhe B. P. kanë qenë banorë të Njesisë Bashkiake Nr. 5, Tiranë, në adresën: rruga “S. D.”, p. nr. 1;

ii) në datën 12.1.2012, znj. H. P. ka aplikuar pranë Njesisë Bashkiake Nr. 5, për t’u trajtuar me strehim në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” i ndryshuar;

iii) në momentin e aplikimit familja e shtetasës H. P. përbëhej nga 4 persona, ajo dhe 3 fëmijët M. P., Rezarta Paja dhe B. P.;

iv) është vërtetuar se shtetasja H. P. dhe fëmijët e saj nuk kanë pronë të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë dhe as pasuri të llojit “apartament banimi” në Elbasan, sipas ZVRPP-së Elbasan;

v) është vërtetuar se shtetasja H. P. dhe dy djemtë e saj M. dhe B. P. janë të papunë, dhe se e vetmja në marrëdhënie pune është vajza Rezarta Paja, e cila ka të ardhura mujore në shumën 76,500 lekë;

vi) është vërtetuar se shtetasja H. P. dhe djemtë e saj nuk ushtrojnë aktivitetet ekonomik dhe nuk janë subjekte të tatim-taksave;

vii) me vendimin nr. \*\*\*<sup>25</sup>, datë 5.4.2012, të Këshillit Bashkiak për “Trajtimin e familjeve që përfitojnë nga projekti për subvencionimin e interesave të kredisë”, shtetasës H. P. i jepet kredi e lehtësuara nga shteti<sup>26</sup>;

<sup>23</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2021, nga BKT-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>24</sup>Shihni praktikën e kredisë bashkëlidhur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2021, nga Bashkia Tiranë dhe BKT, dërguar me pyetësorin nr. 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>25</sup>Shihni vendimin, datë 5.4.2012, të Këshillit Bashkiak, publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Tiranë.

<sup>26</sup>Mbështetur në pikën 2 të nenit 7 dhe në germën “g”, të pikës 3/I, të nenit 10, të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar); Vendimin Nr. 53, datë 28.1.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e dokumentacionit të nevojshëm, afateve dhe procedurave për të përfituar strehim nga programet e banesave sociale me qira”; Vendimin Nr. 814, datë 3.12.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” (i ndryshuar); Vendimin Nr. 51, datë 19.12.2008, të Këshillit Bashkiak, “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e

viii) me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2012, Bashkia Tiranë i ka përcjellë BKT-së vendimin nr. \*\*\*, datë 15.4.2012, të Këshillit Bashkiak, ku evidentohet si përfituese edhe shtetasja H. P.;

ix) nga ana e BKT-së janë administruar të dhëna të dokumentuara mbi të ardhurat e kredimarrëses dhe dorëzanësve, pasuri të paluajtshme, detyrime ndaj personave fizikë apo juridikë, si dhe procedime penale në emër të tyre.

### **1.3. Arsyetimi ligjor bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe vlerësimi i Komisionit në lidhje me kredinë**

**1.3.1. Për sa i takon përmbushjes së kriterëve ligjore për përfitimin e kredisë së butë,** ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, në nenin 4 të tij parashikon se familjet që klasifikohen për t’u trajtuar me programe sociale të strehimit, miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak, sipas kriterëve: “(a) nuk kanë në pronësi një banesë; (b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje; (c) kanë mbetur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore. Përfshihen në një nga gerrat ‘a’, ‘b’ dhe ‘c’ vetëm ato familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji”. Po sipas këtij ligji, administrimi i kërkesave për programet sociale të strehimit dhe caktimi i përparësive bëhen nga organet e qeverisjes vendore. Të njëjtat kriterë të parashikuara nga ligji janë përcaktuar edhe në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, i ndryshuar. Megjithatë, sipas këtij udhëzimi, miratimi me vendim të Këshillit Bashkiak nuk e bën familjen automatikisht përfituese, pasi banka mund të kërkojë dokumente plotësuese për të mbështetur informacionin e dhënë mbi nivelin e të ardhurave të familjes, çka në rastin konkret rezultoi të jetë kryer nga ana e BKT-së. Pra, pas miratimit të përfitimit të kësaj kredie nga Këshilli Bashkiak, dhënia e saj është miratuar edhe nga BKT-ja.

Në lidhje me kriterin e mospasjes së një banese në pronësi të aplikuesit për efekt të marrjes së një kredie me kushte lehtësuese, nga banka kredidhënëse janë kryer verifikimet, në përfundim të të cilave nuk ka pasur të dhëna për pasuri të paluajtshme në emër të nënës së subjektit, subjektit dhe anëtarëve të tjerë të familjes. Por, gjatë hetimit administrativ, nga Komisioni u kryen verifikime të mëtejshme nëse në momentin e marrjes së kredisë subjekti dhe nëna e saj, në cilësinë e kredimarrësve, kanë pasur pasuri të tjera në pronësi. Konkretisht, nga informacioni i vënë në dispozicion nga ASHK-ja, FSHU-ja dhe UKT-ja<sup>27</sup>, nuk rezultuan të dhëna për pasuri të tjera përveç apartamentit të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, të blerë me kredinë objekt shqyrtimi, ku nëna dhe vëllezërit e subjektit banojnë aktualisht, tokave të llojit “arë” dhe banesës në G., Elbasan.

Për sa i takon banesës në G., Elbasan, ka rezultuar se babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri H. P., i cili ka ndërruar jetë në vitin 2000, kishte ndërtuar vite më parë një shtëpi banimi njëkatëshe me sip. 145 m<sup>2</sup>, mbi një sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, për të cilën nuk ka të dhëna se kur është regjistruar për herë të parë, por në vitin 2017, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore në emër të tij, kjo pasuri është regjistruar si pasuria nr. \*\*\*, G., Elbasan, në emër të trashëgimtarëve ligjorë të tij. Pra, nëna e subjektit, subjekti dhe vëllezërit e saj, në momentin e aplikimit për kredi të butë me statusin e të pastrehut në vitin

---

strehimit dhe sistemit të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”; urdhëresa nr. 215, datë 8.4.2009, e Kryetarit të Bashkisë “Mbi procedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar kredi të lehtësuara nga shteti” (i ndryshuar); me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak.

<sup>27</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2020, të FSHU-së; shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020, të UKT-së; shkresën kthim përgjigje nga ASHK-ja vendore dhe dokumentet bashkëlidhur përgjigjeve të pyetjeve të datës 17.2.2021, në dosjen e Komisionit.

2012, kane qenë bashkëpronarë *de facto* mbi tokën bujqësore si anëtarë të familjes bujqësore, sipas ligjit nr. 7501 dhe mbi ndërtesën me sip. 145 m<sup>2</sup> në G., Elbasan.

Me qëllim një vlerësim sa më objektiv në lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore për marrjen e kredisë, Komisioni i ka kërkuar Këshillit Bashkiak Tiranë nëse në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, pasja në bashkëpronësi e një pasurie të përfituar me ligjin nr. 7501 dhe një ndërtesë mbi të (në një qytet të ndryshëm nga qyteti në të cilin është miratuar kredia lehtësuese) përbën ose jo kusht ndalues për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria e Strehimit Social<sup>28</sup> në Bashkinë Tiranë ka informuar se përfitimi i pronës sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, nuk përbën kriter skualifikues për programet sociale të strehimit, ndërkohë që nuk bën fjalë për ndërtesën e ngritur mbi objektin e ngritur mbi tokën bujqësore.

Në përfundim të procesit, bazuar në të gjitha sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se kredia e marrë në datën 19.9.2012, në shumën 4,950,000 lekë është dhënë në respektim të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, pasi në momentin e marrjes së kredisë, nëna e subjektit dhe anëtarët madhorë të familjes nuk kanë pasur pasuri të paluajtshme të regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, pra në territorin e njësisë vendore nga e cila është akorduar kredia, dhe jo vetëm. Për sa i takon shtëpisë së banimit me sip. 145 m<sup>2</sup> në fshatin G., Elbasan, Komisioni çmoi se kjo banesë nuk mund të përbente pengesë ligjore për marrjen e kredisë për shkak se në momentin e marrjes së kredisë kjo pasuri nuk ka qenë e regjistruar në ZVRPP-në Elbasan. Për sa i takon pronësisë *de facto*, u vërtetua që kjo banesë është banuar nga dy kurora familjare, konkretisht nga: (i) familja e origjinës së subjektit me kryefamiljare nënën e saj H. P. deri kur familja është shpërngulur në Tiranë fillimisht në një banesë të mare me qira në vitin 2006<sup>29</sup>, e me pas në apartamentin e blerë në Y.; (ii) familja e vëllait nga babai të subjektit, z. N. P., i cili ka banuar dhe vijon të banojë në këtë banesë. Pra, është dukshëm e qartë se banesa me sip. 145 m<sup>2</sup> në fshatin G., Elbasan, përveç faktit që në momentin e aplikimit të kredisë, viti 2012, nuk banohej nga nëna e subjektit dhe fëmijët e saj, nuk ka qenë e mjaftueshme për banimin e dy familjeve dhe, për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi se nuk mund të bëhej pengesë për marrjen e kredisë nga nëna e subjektit si kryefamiljare, me qëllim blerjen e një banese në Tiranë në vitin 2012.

Për sa më sipër, nuk u evidentuan problematika në lidhje me dhënien e kredisë në kundërshtim me kriteret ligjore.

### **1.3.2. Për sa i takon statusit të subjektit si palë kredimarrëse dhe pronësisë së mundshme të saj mbi apartamentin e blerë me këtë kredi, Komisioni ka konstatuar se:**

**a.** Për shkak të statusit si bashkëkredimarrëse, në DPV-të e viteve 2012 - 2016 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka kryer deklarime në lidhje me kredinë, si dhe në lidhje me shlyerjen e saj dhe detyrimet e mbetura.

**b.** Në procesverbalin e pyetjes së subjektit në ILDKPKI, në datën 30.9.2014<sup>30</sup>, ndër të tjera, ka deklaruar se: “*Kredia është fituar si kredi e butë nga Bashkia, për të pastrehët kur kam qenë në gjendje familjare me nënën dhe dy vëllezërit. Është marrë nga të katër familjarët, por aplikuesja ka qenë nëna ime si kryefamiljare, prandaj i gjithë dokumentacioni është bërë në emër të saj, përfshirë edhe kontratën e shitjes së apartamentit. Rrjedhimisht, edhe detyrimet në*

<sup>28</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2021, nga Drejtoria e Strehimit Social të Bashkisë Tiranë, në dosjen e Komisionit.

<sup>29</sup>Shihni deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 28.1.2020, të shtetasve H. M. dhe A. M., bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, në dosjen e Komisionit, e cila konfirmon që nëna e subjektit ka marrë apartamentin e tyre me qira që në vitin 2006, kur subjekti filloi studimet në Shkollën e Magjistraturës.

<sup>30</sup> Shihni dokumentin në dosjen e Komisionit.



*lidhje me çmimin dhe kredinë janë ndarë në katër pjesë. Kredia është marrë nga unë dhe nëna ime si kreditore, pasi në atë moment unë isha person që siguroja të ardhura dhe tre familjarët e tjerë kanë qenë të papunë. Vëllezërit kanë kontribuar pjesën e tyre dhe konkretisht vëllai i madh me kursimet e tij nga emigracioni ka kontribuar 1,200,000 lekë”.*

**c.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se aplikimi si kredimarrëse në BKT u bë nga nëna e saj H. P., ndërsa ajo dhe dy vëllezërit e saj aplikuan si dorëzanës. Subjekti sqaron se, lidhur me cilësimin e saj si bashkëkredimarrëse u vu në dijeni në momentin e njohjes me kontratën e kredisë dhe për këtë i kishte kërkuar sqarime bankës. Sipas saj, nga ana e bankës ishte gjetur kjo zgjidhje, pasi nëna e saj H. P. ishte në moshë të madhe, dhe duke qenë se kredia kishte afat 30-vjeçar ekzistonte mundësia të mos shlyhej. Nga ana tjetër, nëse nuk pranonte cilësimin e bashkëkredimarrëses, ekzistonte mundësia që nëna e saj të mos e përfitonte kredinë e butë, dhe për më tepër që kontrata premtim shitjeje me shitësit e apartamentit K. dhe E. C. ishte lidhur.

Ky deklaram rezulton të jetë i vërtetë, referuar dokumentacionit të kredisë së administruar nga BKT-ja, ku znj. Rezarta Paja së bashku me dy vëllezërit e saj B. P. dhe M. P. kanë plotësuar formularin e dorëzanësit në datën 23.6.2012. Për më tepër, përfshirja në kredi si bashkëkredimarrës apo dorëzanës e të gjithë personave, të cilët ndodhen në të njëjtën certifikatë familjare është një praktikë e njohur e menaxhimit të riskut të kredisë, e cila aplikohet në të gjitha bankat e nivelit të dytë.

**ç.** Për sa i takon përdorimit të apartamentit të blerë me kredi, po në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se aktualisht kjo banesë përdoret nga nëna H. P., vëllai i vogël B. P. dhe vëllai M. P. me bashkëshorten dhe vajzën e tij. Më tej, subjekti ka sqaruar se pavarësisht se në momentin e përfitimit të kredisë ajo ishte anëtare e familjes, në asnjë moment nuk ka pretenduar të jetë pronare apo bashkëpronare mbi këtë pasuri, përveçse garantore e kredisë së marrë nga nëna e saj, pasi kjo banesë u ble për të jetuar familja dhe se ajo ishte shkëputur dhe nuk jetonte më aty që prej datës 14.2.2013, kur u martua. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur: certifikatat personale të shtetasve H. P., B. P., M. P. dhe A. P., ku rezulton se adresa e banimit e secilit prej tyre është ajo e apartamentit në Y., Tiranë; certifikatë familjare e shtetasit M. P.; si dhe 7 foto nga apartamenti.

**d.** FSHU-ja<sup>31</sup> ka konfirmuar kontratën e furnizimit me energji me nr. \*\*\*, në Kashar, Tiranë, në emër të shtetasës H. P., ku pagesat nisin prej vitit 2009 dhe deri në vitin 2021. Ndërsa subjekti paraqiti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 kopje të librezës së kësaj kontrate në emër të shtetasës H. P., e cila përmban të dhëna për pagesat që prej vitit 2014. Për vitet 2012 - 2014 duket se kontrata e energjisë elektrike ka qenë në emër të pronarit paraardhës të pasurisë.

**dh.** UKT-ja<sup>32</sup> ka informuar kontratën nr. \*\*\* për objektin në Y., Tiranë në emër të shtetasës H. P.. Ndërsa subjekti paraqiti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 librezën e furnizimit me ujë të kësaj kontrate në emër të shtetasës H. P., e cila përmban të dhëna për pagesat e shpenzimit të saj që prej vitit 2013.

**e.** Për nënën e subjektit, znj. H. P., nuk u vërtetua që të ketë përfituar pasuri tjetër të paluajtshme në Tiranë, pas blerjes së apartamentit në Y., Tiranë, blerë pjesërisht me kredi lehtësuese.

**ë.** Pasi iu kërkuua nga Komisioni me njoftimin e rezultateve të hetimit të vërtetohet nëse vëllezërit e saj M. dhe B. P. kanë pasur/kanë pasuri të paluajtshme në Tiranë, në parashtrimet e saj subjekti Rezarta Aliu ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2021, dhe vërtetimin nr.

<sup>31</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2020, nga FSHU-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>32</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020, nga UKT-ja, në dosjen e Komisionit.

\*\*\* prot., datë 12.4.2021, nga ASHK-ja, Tirana Veri, sipas të cilave vërtetohet se në emër të shtetasve M. H. P. dhe B. H. P. nuk figuron e regjistruar ndonjë pasuri.

Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha provat e administruara gjatë hetimit administrativ, vlerësimin e tyre me objektivitet dhe në raport me deklaratimet e subjektit, nuk ka pasur më dyshime në lidhje me pronësinë e mundshme të subjektit të rivlerësimit në apartamentin e banimit në Y., Tiranë, apo përfitimin e kredisë prej saj në mënyrë të paligjshme, referuar në mënyrë të përmbledhur fakteve dhe rrethanave, si vijojnë:

i) Për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese në BKT, ka aplikuar si kryefamiljare nëna e subjektit, znj. H. P., ndërsa subjekti i rivlerësimit ka aplikuar me cilësinë e dorëzanesës dhe më pas është përfshirë si bashkëkredimarrëse.

ii) Kredia e marrë në datën 19.9.2012 nuk ka pasur si qëllim në vetvete blerjen e ndonjë pasurie nga subjekti i rivlerësimit, por ka pasur si qëllim blerjen e një pasurie nga nëna e saj H. P. si kryefamiljare e familjes, pjesë përbërëse e të cilës ka qenë edhe subjekti deri në vitin 2013, kur është martuar. Pra, statusi i subjektit si bashkëkredimarrëse në kontratën e kredisë duket të ketë qenë i kushtëzuar nga politikat e bankës për të siguruar garanci sa më të forta për dhënien e kredisë, ashtu sikurse subjekti pretendon.

iii) Kredia është përfituar nga nëna e subjektit si e pastrehë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për programet sociale të strehimit, dhe jo nga subjekti për shkak të funksionit të saj si gjyqtare.

iv) Për shkak të statusit si bashkëkredimarrëse, subjekti është treguar korrekte me ligjin në deklaratimet periodike dhe në deklaratën *Vetting*, pasi ka deklaruar rregullisht dhe saktësisht shlyerjen e kësteve dhe detyrimin e mbetur.

v) Pasuria apartament banimi në Y., Tiranë, blerë pjesërisht me kredinë objekt shqyrtimi, është përdorur nga nëna e subjektit dhe vëllezërit e saj që kur është blerë në vitin 2012 dhe në vijim. Ndërsa subjekti, si anëtare e familjes, ka banuar aty deri sa është martuar në vitin 2013, fakt i deklaruar prej saj në DPV-në e vitit 2012, ku si adresë banimi është deklaruar adresa e këtij apartamenti. Më pas, në DPV-të në vijim nuk është deklaruar më kjo pasuri.

vi) Nuk u vërtetua që nëna e subjektit dhe vëllezërit e saj të kenë në pronësi pasuri të tjera të paluajtshme, përveç atyre në fshatin G., Elbasan, përfituar nga ligji nr. 7501, fakt që hedh dritë mbi deklaratimin se subjektit se kjo pasuri është blerë për të banuar prej tyre.

vii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka mohuar në asnjë rast kontributin e saj për blerjen e kësaj banese, në shenjë mirënjohjeje për sakrificat e familjes së saj të origjinës dhe nuk ka shfaqur asnjëherë pretendime mbi këtë pasuri.

**1.4. Në lidhje me apartamentin e banimit me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, blerë pjesërisht kredinë e sipërpërmendur, gjatë hetimit administrativ janë kryer verifikimet e mëposhtme.**

**1.4.1. Sa i takon procedurave ligjore për përfitimin e pasurisë nga aktet e administruara<sup>33</sup>** në rend kronologjik, u vërtetua të jenë kryer veprimet e poshtëshënuara:

**a.** Me kontratë premtim për shitje pasurie nr. \*\*\*, datë 7.8.2012, shtetasit K. dhe E. C., premtojnë t'i shesin blerëses H. P. apartamentin e banimit me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, në Y. Tiranë, në shumën 6,187,500 lekë, vlerë nga e cila është likuiduar shuma 1,237,500 lekë *cash* jashtë zyrës noteriale, kurse diferenca do të likuidohet nëpërmjet kredisë.

**b.** Me kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 20.11.2012, pra, dy muaj pasi është lidhur kontrata e kredisë, datë 19.9.2012, znj. H. P. ka blerë nga shtetasit K. dhe E. C.

<sup>33</sup> Shihni dokumentet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr.\*\*\* prot., datë 19.1.2021, nga BKT-ja në dosjen e Komisionit.

apartamentin me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, në çmimin 6,186,500 lekë, në Y., Tiranë. Nga lëvizjet e llogarisë së kredisë në emër të znj. H. H. P. në BKT, rezulton se në datën 10.10.2012 është disbursuar shuma e kredisë prej 4,950,000 lekësh. Në datën 10.10.2012, shuma prej 4,900,000 lekësh është transferuar nga llogaria e znj. H. P. në llogarinë e shitësve të pasurisë K. dhe E. C..

c. Sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 30.11.2012, rezulton e regjistruar në emër të znj. H. P., pasuria nr. \*\*\* e llojit apartament me sip. 92.7 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Y. Tiranë. Nga kartela e pasurisë rezulton se kjo pasuri është vendosur si garanci në favor të BKT-së për kredinë e marrë në shumën 4,950,000 lekë, për një afat 360 muaj.

Nuk janë evidentuar problematika në procedurat ligjore të fitimit të pronësisë.

**1.4.3. Për sa i takon burimeve financiare për blerjen e apartamentit,** u konstatua se si të tilla janë përdorur:

a. Burimi: shuma prej 1,237,500 lekësh, paguar *cash* shitësve K. dhe E. C. në datën 7.8.2012, sipas kontratës premtim për shitje me këtë datë.

Me qëllim vërtetimin e burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e kësaj shume dhe kontributit për pagimin e çmimit të shitjes, Komisioni iu referua deklarimeve të subjektit si vijon:

- Në procesverbalin e pyetjes në vitin 2016 në ILDKPKI, ku ndër të tjera, shprehet *detyrimet në lidhje me çmimin dhe kredinë janë ndarë në katër pjesë, vëllezërit kanë kontribuar pjesën e tyre dhe konkretisht vëllai i madh me kursimet e tij nga emigracioni ka kontribuar 1,200,000 lekë*, nënkuptohet se pasuria është blerë me kontribut të përbashkët të pjesëtarëve të familjes.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se si burim janë përdorur edhe kursimet e vëllait të saj, z. M. P., të realizuara nga puna në shtetin grek, ku ka emigruar nga mesi i viteve '90 e në vazhdim, i cili ka pasur të ardhura minimale si punëtor bujqësie duke u përjashtuar nga tatimi i tyre. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore<sup>34</sup> të përkthyer dhe të noterizuara sipas të cilave rezulton se vëllai M. P. ka jetuar në Greqi për periudhën 2001 – mars 2006, por pa provuar se ka përfutur të ardhura të ligjshme në shtetin grek.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka pretenduar kursime të tjera familjare që kanë ardhur nga të ardhurat e aktivitetit bujqësor të familjes, si dhe kursime të vogla që ka bërë në kohë nëna e saj H. P. nga puna e saj edhe e fëmijëve duke paraqitur një vërtetim datë 20.1.2021, lëshuar nga Bashkia Belsh, me të cilin vërtetohen pagesat e taksës së tokës dhe të ardhurat vjetore nga toka bujqësore për të gjithë periudhën, deri në vitin 2021, në shumën 363,512 lekë.

Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare me të dhënat që disponoheshin deri në datën e pagesës së shumës prej 1,237,500 lekësh, datë 7.8.2012, paraqitur në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese:

Përshkrimi	Periudha 9.2.2012 – 7.8.2012
<b>Pasuritë</b>	<b>1 298 326</b>
Apartament me sip. 92.7 m <sup>2</sup> , në Y. ,Tiranë	1 237 500

<sup>34</sup> Deklaratë përgjegjësie datë 4.2.2020, të shtetasit P. K., i cili deklaroi se shtetasi M. H. P., gjatë periudhës 2001 – 2006, ndodhej në Njësinë Komonale Ch. dhe ka punuar si bujk; deklaratë përgjegjësie datë 26.4.2006, e z. M. H. P., i cili deklaroi se në vitin 2005 nuk ka dorëzuar deklaratë tatimore mbi të ardhurat si individ, pasi ai nuk ka pasur të ardhura për vitin 2004; vërtetim për çeljen e numrit të sigurimeve shoqërore, si dhe vërtetim për ndryshimin e të dhënave personale të personit fizik/individit; leje pune për shtetasin M. P.; leje qëndrimi për shtetasin M. P. në shtetin grek; pasaportë e shtetasit M. P., vitet 2001 – 2006.

<i>Shtesa /pakësime/likuiditete</i>	60 826
Gjendja e likuiditeteve	540
<b>Të ardhurat</b>	<b>1 619 504</b>
Paga e subjektit <sup>35</sup>	462 569
Të ardhura nga toka bujqësore	152 803
Të ardhura të kursyera nga nëna (para emërimit të subjektit në detyrë)	504 132
Hua nga person fizik datë 29.6.2012	500 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>831 558</b>
Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së, për katër persona	273 743
Shpenzime transporti	18 047
Shlyerje këste të kredisë 554,665 lekë në “Raiffeisen Bank”	417 767
Shlyer kredia 400,000 lekë tek “Intesa Sanpaolo Bank”	37 000
Shpenzime qiraje (sipas pyetësorit standard)	85 000
Mundësia për kursime	<b>-510 380</b>

Sipas kësaj analize, duket se familja e subjektit nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të kryer pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në pronësi të znj. H. P., në shumën 1,237,500 lekë, për shkak të një balance negative prej - 510,380 lekësh, konstatim për të cilin, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën.

Gjithashtu, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është bërë me dije se në analizën financiare kumulative si më sipër, të ardhurat nga toka bujqësore të cilat janë administruar nga nëna e saj H. P., janë konsideruar sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Belsh më 20.1.2021, në masën 6/7 pjesë (pjesët takuese të familjes me kryefamiljare znj. H. P.<sup>36</sup>), duke përjashtuar 1/7 pjesë të vëllait nga babai të subjektit të rivlerësimit, z. N. P., i cili jetonte në familje më vete. Por, duke qenë se VKM-ja me nr. 1053, datë 23.4.2008, përcakton minimumin e të ardhurave që mund të përfitohen nga toka bujqësore në varësi të llojit dhe sipërfaqes dhe nuk provon të ardhura konkrete të përfituara çdo vit, si dhe në kushtet kur nuk vërtetohet tatimi mbi të ardhurat nga toka bujqësore, me kalimin e barrës së provës subjektit iu kërkua të vijojë të paraqesë shpjegime e dokumente shkresore për të vërtetuar të ardhura konkrete nga toka bujqësore, si fatura të shitjes së produkteve bujqësore a blegtorale, kontrata, marrëveshje, deklarata, vërtetime nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe zhvillimit rural, etj., si dhe dokumente shkresore nëse familja e origjinës së saj ka përfituar/përfiton asistencë sociale.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

Së pari, në parashtrimet e saj, subjekti i ka kërkuar Komisionit që të përjashtohet nga barra e provës për të vërtetuar mundësinë e pagimit nga nëna e saj të shumës 1,237,500 lekë, për blerjen e apartamentit në pronësi të saj. Ajo ka referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i

<sup>35</sup> Në pagën e subjektit nuk janë përfshirë dietat e përfituara prej saj.

<sup>36</sup> Sipas certifikatës së trungut familjar të vitit 1974, në përbërjen familjare të subjektit rezultojnë të jenë 8 persona, përfshirë babain e subjektit, ndërruar jetë në vitin 2000 dhe vëllain nga babai, N. P.. Sipas certifikatës familjare të vitit 2007, N. P., nuk ka qenë më pjesë e trungut familjar. Ndërkohë, që subjekti deklaroi se të ardhurat nga toka bujqësore për të gjithë familjen janë administruar nga nëna e saj.

Posaçëm i Apelimit në vendimet nr. 20, datë 8.9.2020, që i përket subjektit F. L.<sup>37</sup> dhe nr. 21, datë 10.9.2020, që i përket subjektit R. J<sup>38</sup>.

Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet përpara të njëjtave kushte si në rastet e referuara, pasi gjatë procesit të rivlerësimit është provuar lidhja e interesit mes saj dhe nënës së saj, bazuar në faktet: (i) subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e përbërjes familjare të nënës H. P. në momentin e pagimit të shumës 1,237,500 lekë, kur është lidhur kontrata për premtim për shitje pasurie nr. \*\*\*, datë 7.8.2012, periudhë në të cilën ka ushtruar detyrën e gjyqtarës. Sipas deklarimeve, znj. Rezarta Aliu, ka kontribuar së bashku me anëtarë të tjerë të familjes në pagimin e kësaj shume dhe kjo është arsyeja që analiza financiare e subjektit, për periudhën paramartesore, pra, para vitit 2013, është bërë për të gjithë familjen e saj të origjinës; (ii) subjekti i rivlerësimit është bashkëkredimarrëse në kredinë e marrë për blerjen e këtij apartamenti, pavarësisht kushteve në të cilat është marrë kredia; (iii) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti janë dorëzanës nëpërmjet një depozite bankare për kredinë e marrë; (iv) janë vërtetuar disa pagesa këstesh të kësaj kredie nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë deklaruar rregullisht në DPV, ashtu sikurse edhe detyrimi i mbetur.

Për të gjitha këto arsye, Komisioni ka çmuar se plotësohen kushtet e pikës 14 të nenit 3 dhe se nëna e subjektit duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur.

Së dyti, sa i takon balancës negative prej 510,380 lekësh, subjekti pretendoi se nëna ka pasur mjaftueshëm të ardhura për pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit në pronësi të saj duke deklaruar të njëjtat burime sikurse në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 3<sup>39</sup>. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur disa dokumente të reja<sup>40</sup> midis të cilave aktvlerësimin nr. \*\*\*, datë 20.4.2021, lëshuar nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë, nga i cili evidentohet se të ardhurat *neto* nga toka në pronësi të familjes Paja janë në shumën 686,500 lekë, por pa iu referuar një viti konkret.

Gjithashtu, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, duke kërkuar nga Komisioni që të merren në konsideratë: (i) të ardhurat nga toka bujqësore sipas aktvlerësimit datë 20.4.2021; (ii) kursimet nga emigracioni i vëllait në shumën 3,000 euro/vit; dhe (iii) të reduktohen shpenzimet e jetesës në masën 50% për shkak të jetesës së familjes së saj në fshat dhe përfitimit të produkteve bujqësore të realizuara nga toka.

Në analizë të pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura, Komisioni vlerësoi që të rishikojë analizën financiare dhe konkretisht të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore, pasi sa i takon kursimeve të vëllait në emigracion, pavarësisht shpjegimeve të detajuara, subjekti nuk ka vërtetuar të ardhura të ligjshme të vëllait M. P. në shtetin grek.

Sa i takon të ardhurave nga toka bujqësore, nga krahasimi i dy akteve shkresore të paraqitura nga subjekti, vërehet se: (i) vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Belsh mbi bazën e të cilit ishin

<sup>37</sup> Një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur kryesisht duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

<sup>38</sup> Referuar interpretimit të mësipërm (pika 14, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016) trupi gjykues vlerëson se vetëm fakti që subjekti i rivlerësimit edhe pse ka krijuar familjen e tij vazhdon të jetojë ende me prindërit dhe për këtë arsye është duke i përdorur pasuritë e tyre, nuk mjafton për të provuar se subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij janë në një marrëdhënie interesi pasuror.

<sup>39</sup> Të ardhura të kursyera nga emigracioni i vëllait M. P.; të ardhura nga përdorimi i tokës bujqësore; kursime të tjera të vogla bërë në kohë nga nëna e subjektit.

<sup>40</sup> Vërtetim notash datë 23.6.2003, nga shkolla e mesme profesionale "M. Sh." C., dega zooteknik për motrën F. P.; vërtetim notash datë 23.5.2013, nga shkolla e mesme profesionale "M. Sh." C., dega makineri bujqësore për vëllain M. P.; diplomë "Bachelor" në degën inxhinieri agrare, Universiteti Bujqësor i Tiranës, marrë nga B. P. në vitin 2019; nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të provojë se arsimimi i të gjithë fëmijëve të familjes i është përshtatur aktivitetit bujqësor dhe blegtoral; tre vërtetime me nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2021, nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2021, nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2021 lëshuar nga Zyra e Shërbimeve Sociale pranë Njësisë Administrative Kashar, Bashkia Tiranë, nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të provojë se asnjë nga anëtarët e familjes nuk përfiton asistencë sociale, gjë që mbështet faktin se familja përfiton të ardhura me të cilat mbulon shpenzimet e jetesës.

përlllogaritur të ardhurat nga toka bujqësore, në përfundimin e hetimeve përcakton minimumin e të ardhurave që mund të përfitoheshin për çdo vit nga toka bujqësore në pronësi të familjes Paja, në vlerën 363,512 lekë/vit<sup>41</sup>; (ii) aktvlerësimi, datë 20.4.2021, lëshuar nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë, paraqitur nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, vërteton të ardhura në shumën 686,500 lekë/vit, të cilat i përafrohen më shumë realitetit sepse specifikojnë të ardhura nga kultura bujqësore konkrete dhe shpenzimet e kryera për kultivimin e tyre.

Por, duke qenë se ky aktvlerësimi nuk referon vitin të cilit i takojnë këto të ardhura, Komisioni çmoi të konsiderojë të ardhurat nga toka bujqësore sikurse kishte bërë në rezultatet e hetimit, pra, sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Belsh, i cili përcakton të ardhura për çdo vit në vlerën 363,512 lekë. Ndërsa, Komisioni çmoi të marrë në konsideratë pjesërisht pretendimin e subjektit sa i takon shpenzimeve të jetesës, duke i reduktuar ato në masën 40% për periudhën e analizuar, referuar fakteve: (i) të dhënat e Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë, paraqitur nga subjekti në ushtrimin e barrës së provës, vërtetojnë të ardhura konkrete nga toka bujqësore rreth dy herë më të larta se ato të konfirmuara nga Bashkia Belsh; (ii) gjatë periudhës deri në datën e pagesës së kështit të parë të apartamentit datë 7.8.2012, familja e origjinës së subjektit ka jetuar përgjithësisht në fshat dhe ka paguar rregullisht taksën e tokës. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, sipas analizës financiare të rishikuar, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti dhe familja e saj, kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pagimin e kështit të parë në shumën 1,237,500, për blerjen e apartamentit në datën 7.8.2012.

<b>Përshkrimi</b>	<b>Periudha 9.2.2012<sup>42</sup> – 7.8.2012</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>1 158 326</b>
Apartament sip. 92.7 m <sup>2</sup> , Y., Tiranë	1 237 500
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	-79 174
Gjendja e likuiditeteve	540
<b>Të ardhurat</b>	<b>2 067 644</b>
Paga <i>neto</i> Rezarta Aliu	462 569
Të ardhura nga toka bujqësore	152 803
Kursime nga nëna në vite të kaluara/para emërimit të subjektit në detyrë <sup>43</sup>	952 272
Hua nga person fizik deri më 29.9.2013, por i shtyrë verbalisht	500 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>722 061</b>
Shpenzime jetike	273 743
Reduktim shpenzimesh	-109 497
Shpenzime transporti	18 047
Shlyerje këste për kredinë 554,665 lekë në “Raiffeisen Bank”	417 767
Shlyerje këste për kredinë 400,000 lekë në “Intesa Sanpaolo Bank”	37 000
Shpenzime qiraje sipas pyetësorit standard	85 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>187 257</b>

<sup>41</sup> Kjo shpresë i referohet VKM-së nr. 10583, datë 23.4.2008, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 787, datë 14.12.2005, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, propozuar nga ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, vendim i cili përcakton minimumin e të ardhurave që mund të përfitohen nga toka bujqësore në varësi të llojit dhe sipërfaqes së saj.

<sup>42</sup> Analiza financiare fillon në këtë datë, pasi periudha 1.1.2012 – 9.2.2012 është analizuar më vete, për të shmangur çdo mbivendosje të mundshme, pasi në datën 9.2.2012 subjekti ka kryer depozitimin e shumës 210,000 lekë, trajtuar më poshtë.

<sup>43</sup> Nga tetori i vitit 2006 kur subjekti ka filluar Shkollën e Magjistraturës deri në datën e pagesës së kështit të parë të apartamentit datë 7.8.2012.

b. Burimi: kredi në vlerën 5,000,000 lekë, disbursuar më 10.10.2012, nga e cila shuma prej 4,900,000 lekësh është transferuar nga llogaria e znj. H. P. në llogarinë e shitësve të pasurisë K. dhe E. C.. Pas të gjitha verifikimeve u vërtetuan procedurat ligjore të marrjes së kredisë me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, si dhe u vërtetua se deklaratimet e subjektit përputhen tërësisht me informacionin e marrë nga banka kredidhënëse.

#### 1.4.4. Për sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjet e kësteve të kredisë

Nga informacioni bankar rezulton se pagesat për shlyerjet përkatëse janë kryer pjesërisht nga subjekti dhe pjesërisht nga nëna, si në tabelën vijuese:

Vitet	Pagesat e kryera nga subjekti	Pagesat e kryera nga nëna e subjektit	Total
2012	45 000	0	45 000
2013	62 000	147 000	209 000
2014	42 000	189 000	231 000
2015	59 400	246 000	305 400
2016	0	268 000	268 000
<b>Total</b>	<b>208 400</b>	<b>850 000</b>	<b>1 058 400</b>

Nga verifikimi i DPV-së së vitit 2012 e në vijim, rezulton se subjekti i ka deklaruar rregullisht shlyerjet e kredisë prej saj dhe nënës së saj. Nga analiza financiare e këtyre viteve rezultoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kësteve të kryera prej saj, për shkak se të gjitha këto vite janë me balanca pozitive. Sa i takon pagesave prej nënës, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se për shlyerjen e kredisë, pas martesës në shkurt të vitit 2013, kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga dy vëllezërit M. dhe B. P., të ardhurat nga toka bujqësore, të ardhurat nga paga e bashkëshortes së vëllait A. P. dhe nga pensioni i nënës. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur dokumentet si vijojnë:

- vërtetim datë 20.1.2021, nga Bashkia Belsh, që vërteton pagesën e taksës së tokës;
- vërtetim nga ISSh-ja për bazën e vlerësuar datë 1.2.2021, për pagën e periudhës maj 2013 – shkurt 2014, të vëllait B. P.;
- ekstrakt nga DPT-ja, datë 28.1.2021, i cili informon mbi pagën dhe detyrimet e paguara nga punësimi i vëllait B. P. për periudhën maj 2013 – shkurt 2014;
- certifikatë martesë datë 8.2.2021, të shtetasve A. dhe M. P., që vërteton datën e martesës se është 29.5.2017, vërtetim page të znj. A. P. dhe certifikatë familjare të z. M. P.;
- vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021, lëshuar nga ISSh-ja Tiranë, i cili na informon mbi pensionin e znj. H. P. për periudhën 27.4.2018 – 28.2.2021;
- certifikatë personale të shtetasve H., B., M. dhe A. P. ku rezulton se adresa e banimit e secilit prej tyre është apartamenti në pronësi të znj. H. P..

Bazuar në sqarimet e dhëna nga subjekti dhe në dokumentet e paraqitura, për periudhën 2013 – 2016, mundësia për të paguar këstet e kredisë nga nëna e subjektit H. P., pasqyrohet në tabelën vijuese<sup>44</sup>.

Përshkrimi	Periudha 2013 – 2016
<b>Të ardhurat</b>	<b>1 475 829</b>
Paga M. P.	0
Paga B. P.	194 770

<sup>44</sup> Analiza financiare është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative.

Të ardhura nga toka bujqësore	1 246 327
Marrë H. P. nga shërbimi WU	34 733
<b>Shpenzimet</b>	<b>3 311 170</b>
Shpenzimet e jetesës për 3 persona <sup>45</sup>	2 461 170
Paguar këste kredie	850 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1 835 341</b>

Në përfundim të hetimit administrativ, duket se nëna e subjektit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kryer pagesat e kësteve të kredisë në shumën 850,000 lekë, për periudhën 2013 – 2016. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka vijuar të pretendojë se nëna dhe vëllezërit e saj kanë paguar këstet e kredisë duke përdorur të ardhura nga puna e dy vëllezërve, si dhe të bashkëshortes së vëllait M. P.. Për të mbështetur pretendimet, subjekti ka dhenë shumë shpjegime në lidhje me faktin e nxjerrjes së të ardhurave nga puna e vëllait të saj M. P., si dhe ka paraqitur një dokument të ri shtesë<sup>46</sup>, i cili nuk provon të ardhura të ligjshme të tij dhe/ose të anëtarëve të tjerë të familjes për periudhën e analizuar 2013 – 2016. Sa i takon bashkëshortes së vëllait M. P., pretendimi i subjekti nuk është i bazuar, pasi ata janë martuar në vitin 2017, pra pas viteve të analizuar për shlyerjen e kësteve të kredisë.

Në vlerësim të pretendimeve për të ardhurat nga toka bujqësore, Komisioni ka rishikuar analizën financiare, duke reduktuar shpenzimet e jetesës në masën 40%, sikurse trajtuar më sipër, në pikën 1.4.3/a<sup>47</sup>. Edhe në këtë rast, familja e origjinës nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar këstet e kredisë në shumën 850,000 lekë.

Në përfundim të procesit, për një vlerësim sa më objektiv dhe proporcional të pasojës që mund të sjellë ky konstatim për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i është referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë: (i) pas vitit 2013, kur nëna e subjektit ka filluar të shlyejë disa këste të kredisë në total në shumën 850,000 lekë, subjekti është shkëputur nga trangu familjar; (ii) pas këtij viti, subjekti nuk ka pasur asnjë lidhje me apartamentin objekt shqyrtimi dhe asnjë lidhje me nënën apo vëllezërit në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, përveç kontributit të saj në mirënjohje të sakrificës së familjes së origjinës, duke paguar disa këste të kredisë. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se nuk ka arsye për penalizim të subjektit të rivlerësimit për shkak të mosvërtetimit të të ardhurave të ligjshme të mjaftueshme të nënës e vëllezërve të saj për të shlyer kredinë në shumën totale 850,000 lekë pas vitit 2013. Për më tepër, në kushtet kur këta persona nuk kanë qenë subjekte deklarues apo persona të tjerë lidhur me subjektin pas këtij viti, Komisioni nuk ka tagër ligjore e as mundësi objektive për të kryer një analizë të mirëfilltë e të saktë financiare pasurive të tyre.

### 1.5. Në lidhje me shtetasin S. M.

Nga aktet e administruara dhe deklaratimet e subjektit, Komisioni vlerësoi se ky shtetas është në cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 84/2016, për shkak

<sup>45</sup> Gjatë kësaj periudhe në përbërjen familjare kanë qenë nëna dhe dy vëllezërit.

<sup>46</sup> Vendimi nr. 3189, datë 26.11.2020, “Mbi marrjen e masës administrative” të Task-Forcës pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkëngjitur mandatar-këtimi i gjobës, nëpërmjet të cilit subjekti kërkon të provojë se vëllai i saj punon me taksit dhe përfiton të ardhura, por është i palicencuar.

<sup>47</sup> Në analizën financiare të familjes së origjinës së subjektit, edhe për periudhën 2013 – 2016, të ardhurat nga toka bujqësore janë përlllogaritur në 6/7 pjesë të të ardhurave të të gjithë anëtarëve të familjes, duke përjashtuar vëllain nga babai të subjektit, N. P., e duke marrë të mirëqenë deklaratimet e subjektit se të ardhurat nga toka bujqësore janë administruar gjatë gjithë kohës nga nëna e subjektit si kryefamiljare.



të dhënies hua të dy shumave prej 500,000 lekë secila, që ky shtetas i ka dhënë subjektit të rivlerësimit, trajtuar hollësisht në vijim:

### **1.5.1. Në lidhje me dorëzaninë – depozitë në vlerën 500,000 lekë, në BKT**

Sipas kontratës së kredisë nr.\*\*\*, datë 19.9.2012, në BKT, lidhur me nënën e subjektit H. P. dhe subjektin si palë kredimarrëse, në nenin 9 “Sigurimi i kredisë”, paragrafi 9.1.2., përcaktohet se shtetasi S. M. është dorëzanës në këtë kredi me depozitë në pronësi të tij, me vlerë 500,000 lekë.

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaron se në datën 5.8.2015, shuma prej 530,127.41 lekësh (500,000 lekë+interesat) është transferuar me transfertë bankare në BKT nga llogaria e shtetasit S. M., në llogari të subjektit dhe ky shtetas ka hequr dorë nga dorëzania, vërtetuar me *statement* bankar të BKT-së. Subjekti deklaron se shuma 500,000 lekë mbeti në pronësinë e saj dhe të bashkëshortit, si dhe është përdorur prej tyre në këtë mënyrë: (i) në datën 5.8.2015, shuma prej 220,000 lekësh është investuar në depozitë me afat 1-vjeçar dhe është vendosur si kolateral për kredinë me shumë fillestare 4,950,000 lekë, vërtetuar me marrëveshjen siguruuese (me bllokim shume) nr. \*\*\*, datë 8.9.2015, të nënshkruar midis BKT-së dhe shtetasve Rezarta dhe E. Aliu (në cilësinë e dorëzanësit). Kjo depozitë është deklaruar në DPV-në e vitit 2015 në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike ose private”; (ii) në të njëjtën datë 5.8.2015, pjesa tjetër është tërhequr *cash* me qëllim shlyerjen e një pjese të mbetur të një huaje të dhënë nga z. S. M., në shumën 500,000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 29.6.2012<sup>48</sup>. Këto deklarime të subjektit vërtetohen tërësisht me informacionin bankar të administruar.

Sa i takon shkakut të transfertës së shumës 530,127,41 lekë nga z. S. M. në llogari të subjektit në datën 5.8.2015, po në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka sqaruar se me marrëveshje të përbashkët kjo shumë i është dhënë prej saj dorëzanësit S. M., brenda vitit 2014, për shkak se afati i kredisë ishte i gjatë dhe ky shtetas nuk mund të priste në cilësinë e dorëzanësit derisa të shlyhej kredia, duke bllokuar shumën 500,000 lekë të vënë si dorëzani. Për të vërtetuar shlyerjen e detyrimit prej 500,000 lekësh shtetasit S. M., bashkëngjitur pyetësorit standard, subjekti ka vënë në dispozicion tri akte shkresore, si vijojnë:

**a.** Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 4.4.2014, ku z. S. M. deklaron se shuma e depozitës bankare, lënë si garanci për të siguruar kredinë bankare, do të paguhet nga znj. Rezarta Aliu (Paja) në 5 këste me nga 100,000 lekë/45 ditë. Sipas kësaj deklarate kësti i parë prej 100,000 lekësh është paguar me nënshkrimin e kësaj deklarate.

**b.** Deklaratë e thjeshtë me shkrim dore të datës 4.7.2014, ku shtetasi S. M. deklaron se deri në këtë datë janë kryer tri pagesa nga znj. Rezarta Aliu (Paja) në këmbim të depozitës në vlerën 500,000 lekë, si vijon: (i) kësti i parë prej 100,000 lekësh është paguar më 4.4.2014; (ii) kësti i dytë prej 100,000 lekësh është paguar më 20.5.2014; (iii) kësti i tretë prej 100,000 lekësh është paguar në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate, më 4.7.2014. Siç vërehet, kjo deklaratë është nënshkruar tre muaj më vonë se deklarata e parë, fakt që tregon se shuma prej 300,000 lekësh është paguar brenda këtyre muajve: 4.4.2014 - 4.7.2014.

**c.** Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 29.12.2014, ku shtetasi S. M. ka deklaruar se ka marrë prej shtetasës Rezarta Aliu (Paja) shumën 500,000 lekë, e cila i është paguar me këste jashtë kësaj zyre, në këmbim të depozitës bankare të tij nr. \*\*\*, në BKT prej 500,000 lekësh, e lënë si garanci për të siguruar kontratën e kredisë nr. \*\*\*. Më tej, ky shtetas deklaron se kjo është bërë për arsye se ka pasur nevojë për këtë shumë parash dhe duke pasur parasysh faktin se kjo depozitë duhet të qëndronte e bllokuar edhe për disa vite, ra dakord me znj. Rezarta Aliu (Paja) që t’i jepej nga ana e saj shuma 500,000 lekë, duke i kaluar si këmbim shuma e depozituar prej

<sup>48</sup> Kjo hua është trajtuar hollësisht në rubrikën “konstatime të tjera”.

tij në BKT. Pra, sipas kësaj deklarate, shuma 200,000 lekë është paguar brenda periudhës 4.7.2014 – 29.12.2014.

Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka përmendur burimet që kanë shërbyer për të kryer pagesat si më sipër ndaj shtetasit S. M., si vijojnë: (i) kursimet nga paga; (ii) hua nga shtetasja E. C./K.<sup>49</sup>; (iii) mjetet monetare të siguruara nga një kredi bankare konsumatore në “Raiffeisen Bank” sh.a., në datën 27.6.2014. Nga analiza financiare si në tabelën më poshtë, duket se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për dhënien e shumave në periudhat e mësipërme.

Përshkrimi	4.4.2014	20.5.2014	4.7.2014	31.12.2014	2014
<b>Pasuritë</b>	<b>141 996</b>	<b>45 422</b>	<b>303 707</b>	<b>530 065</b>	<b>1 021 191</b>
Dhënë <i>cash</i> te z. S. M.	100 000	100 000	100 000	200 000	500 000
<i>Shtesa /pakësime/likuiditete</i>	41 996	-54 578	203 707	330 065	521 191
Gjendja e likuiditeteve	-128 110	-182 688	21 020	351 085	351 085
<b>Të ardhurat</b>	<b>706 741</b>	<b>269 770</b>	<b>762 842</b>	<b>816 338</b>	<b>2 555 691</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	353 315	96 104	115 510	485 115	1 050 044
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	293 526	73 666	147 332	331 223	845 747
Kredi bankare 59,900 lekë në “Raiffeisen Bank”	59 900				59 900
Kredi bankare 500,000 lekë në “Raiffeisen Bank”			500 000		500 000
Hua 100,000 lekë nga E. C.		100 000			100 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>257 226</b>	<b>106 089</b>	<b>120 907</b>	<b>588 960</b>	<b>1 073 181</b>
Shpenzime jetike	137 800	68 159	66 677	268 192	540 828
Shpenzime transporti	10 192	5 041	4 932	19 836	40 000
Shlyerje interesi 57,200 “Raiffeisen Bank”	12 198	8 132	4 066	24 396	48 792
Pagesë për kredinë 4,950,000 lekë në BKT	10 500	7 000	3 500	21 000	42 000
Pagesë për kredinë 310,500 lekë	26 636	17 757	8 879	53 271	106 543
Pagesë për kredinë 500,000 lekë në “Raiffeisen Bank”			8 853	44 265	53 118
Shlyer huaja 500,000 lekë, datë 29.6.2012				50 000	50 000
Shlyer huaja ndaj E. C.				100 000	100 000
Blerje mallrash konsumi	59 900				59 900
Shpenzime/komisione për kreditë			20 000		20 000
Shpenzime qiraje (sipas pyetësorit standard)			4 000	8 000	12 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>307 519</b>	<b>118 259</b>	<b>338 228</b>	<b>-302 687</b>	<b>461 319</b>
<b>Mundësia për kursime kumulative</b>	<b>307 519</b>	<b>425 777</b>	<b>764 006</b>	<b>461 319</b>	

Nga verifikimi i DPV-ve nuk rezulton që subjekti të ketë kryer deklarime për pagesat e kryera shtetasit S. M. përgjatë vitit 2014, në total shuma 500,000 lekë dhe as pakësim likuiditetesh në këtë shumë, e cila përbën një pasaktësi në DPV për këtë vit. Por, pavarësisht kësaj, shuma prej 500,000 lekësh është konsideruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2014, i cili rezulton me balancë pozitive.

<sup>49</sup> Trajtuar në rubrikën “konstatime të tjera”.

### 1.5.2. Në lidhje me huan në vlerën 500,000 lekë, u konstatua se:

- Në datën 29.6.2012, shtetasi S. M. i ka dhënë hua *cash* subjektit të rivlerësimit, në shumën 500,000 lekë, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 29.6.2012.
- Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar hua në vlerën 500,000 lekë nga shtetasi S. M., prej së cilës shuma prej 450,000 lekësh është derdhur në “Raiffeisen Bank” më 29.6.2012 për shlyerje kredie, deklarim i cili rezulton të jetë i saktë, konfirmuar prej kësaj banke<sup>50</sup>.
- Në DPV-të në vijim për vitet 2013, 2014 dhe 2015 kur është deklaruar shlyerja totale e detyrimit të rrjedhur nga huaja, subjekti ka deklaruar rregullisht në lidhje me këtë hua, konkretisht shumat e shlyera, si dhe detyrimin e mbetur.
- Subjekti ka pasur mundësi për shlyerjen e kësaj huaje sipas deklarimeve, pasi përgjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015, analiza financiare ka rezultuar me balanca pozitive, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

Përshkrimi	2013	2014	2015
Pasuritë	-95 129	521 191	-271 686
Të ardhurat	1 817 931	2 455 691	2 241 334
Shpenzimet	788 621	1 473 180	1 643 650
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>1 124 439</b>	<b>461 320</b>	<b>869 370</b>

### 1.5.3. Analizë e burimit të ligjshëm të shumës 1.000.000 lekë, dhënë prej shtetasit S. M.

Gjatë procesit të rivlerësimit i është kërkuar subjektit të vërtetojë të ardhura të ligjshme të këtij shtetasi që justifikojnë: (i) krijimin e depozitës në vlerën 500,000 lekë vënë si garanci për marrjen e kredisë nga nëna e saj, si dhe (ii) dhënien e huas në shumën 500,000 lekë më 29.6.2012. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se te dyja shumat (prej 500,000 lekësh të shtetasit S. M. janë nga burime të ligjshme, duke paraqitur dokumentet e poshtëshënuara:

- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.12.2010, me palë shitëse z. S. M. për shitjen e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, me vlerë 1,050,000 euro;
- mandat transfertë nga “Union Bank”, datë 2012.2010, ku rezulton se shuma prej 100,000 euro ka kaluar në llogarinë e z. S. M., sipas deklaratës noteriale të mësipërme;
- kontratë shitblerje me nr. \*\*\*, datë 17.2.2011, sipas së cilës z. S. M. ka shitur tri pasuri me vlerë totale 960,000 euro;
- kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\*, datë 26.10.2011, ku shitësi S. M. ka shitur të njëjtat pasuri me çmimin 136,315,300 lekë.

Duke qenë se nga dokumentet e paraqitura si më sipër nuk provohej pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë së paluajtshme nga z. S. M., mënyra e krijimit të depozitës në vlerën 500,000 lekë në BKT dhe mënyra e dhënies së huas prej 500,000 lekësh, subjektit iu kërkua përsëri informacion me pyetësorin nr. 3, në përgjigje të të cilit, ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e pasurive të z. S. M. janë të ligjshme, pasi është paguar tatimi mbi këto të ardhurat në burim. Për të provuar pretendimet e tij, subjekti ka përmendur edhe një herë dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, si dhe ka vënë në dispozicion lëvizje llogarie në euro të shtetasit S. M. në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 11.2.2011 – 31.12.2011, si dhe tri shkresa kthim përgjigje bashkëlidhur të cilave ndodhet

<sup>50</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

praktika e regjistrimit të njëjës prej pronave, datë 1.2.2021, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug.

Nga analiza e të gjitha akteve shkresore të administruara në lidhje me shtetasin S. M., në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se:

Së pari, shuma 1,000,000 lekë e dhënë në total nga z. S. M., e ka burimin te shuma fillestare në lekë<sup>51</sup>, e përfutur nga shitja e pasurive të këtij shtetasi.

Së dyti, sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga shitja e pasurisë, referuar informacionit të ASHK Tiranë, drejtuar blerësit të pasurive, shtetasit K. U., kjo zyrë konfirmon se është kryer regjistrimi i pasurisë në emër të këtij shtetasi dhe në bazë të udhëzimit nr. \*\*\*, datë 26.2.2008, kalimi i pronësisë nga shitësi te blerësi presupozon pagesën e tatimit në burim nga ana e shitësit<sup>52</sup>.

Së treti, nga lëvizjet e llogarive bankare të shtetasit S. M. në “Raiffeisen Bank” ka rezultuar se të dyja shumat prej 500,000 lekësh të vëna në dispozicion të subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, janë tërhequr *cash* nga ky shtetas si vijojnë: (i) shuma 500,000 lekë, në datën 29.6.2012, dhe po në këtë datë i është dhënë subjektit sipas deklaratës noteriale që vërteton dhënien e huas, datë 29.6.2012; (ii) shuma 500,000 lekë, në datën 26.7.2012, ditë në të cilën është depozituar prej tij në BKT, për t’u vendosur si garanci për kredinë e marrë nga nëna e subjektit H. P. në datën 19.9.2012.

Në konkluzion të sa më sipër, për shumën në total 1,000,000 lekë dhënë nga z. S. M. është provuar burimi i krijimit me të ardhura të ligjshme të tij, si dhe është vërtetuar kryerja e veprimeve në rrugë bankare.

**Në lidhje me marrëdhënien e subjektit me shtetasin S. M.**, e pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi marrëdhënien me të dhe rrethanat në të cilat ai ka dalë garant për marrjen e një kredie me afat 30-vjeçar, si dhe dhënien e një huaje në shumën 500,000 lekë, subjekti ka sqaruar se<sup>53</sup> me huadhënësin nuk ka pasur njohje personale dhe se ai e ka ndihmuar për shkak të marrëdhënies së miqësisë bashkëshortin e saj të ardhshëm E. A.. Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 12.1.2021, lëshuar nga shtetasi S. M., në të cilën ka konfirmuar deklaratimet e subjektit.

Nga hetimi administrativ nuk kanë rezultuar procese gjyqësore/vendime të dhëna nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë ndërgjyqëse shtetasin S. M.<sup>54</sup> dhe as procedime penale të regjistruara në emër të këtij shtetasi<sup>55</sup>. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka informuar se pranë kësaj gjykate është regjistruar çështja me nr. \*\*\* akti, datë 18.4.2019, ku palë e tretë ka qenë shtetasi S. M.. Kjo çështje fillimisht i është caktuar me short gjyqtarës Rezarta Aliu (Paja), e cila ka hequr dorë nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është pranuar dhe çështja është rishortuar duke i kaluar me short për gjykim një trupi tjetër gjyqtarës.

<sup>51</sup> Nga lëvizjet e llogarisë së z. S. M. në “Raiffeisen Bank”, vënë në dispozicion nga subjekti me pyetësin nr. 3, rezulton se në datën 25.2.2011 është kredituar shuma 628,400 euro ose 87,303,612 lekë me përshkrimin “sipas kontratës së shitjes së pronës datë 17.2.2011<sup>51</sup> dhe deklaratës noteriale datë 17.2.2011”. Duke ndjekur historikun e llogarisë rezulton se në datën 28.2.2011, shuma prej 286,532 euro është tërhequr *cash* dhe është këmbyer në lekë (rreth 40.000.000 lekë) dhe në po këtë datë është investuar dhe riinvestuar në depozita me afat deri në datën 29.5.2012, datë pas së cilës shuma e përfutur nga investimet në depozita, është lënë e lirë në llogarinë në lekë.

<sup>52</sup> Udhëzimi i përbashkët nr. 9, datë 26.2.2008, i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, pika 10 parashikon se: “Pagesa e detyrimit tatimor bëhet para kryerjes së regjistrimit të aktit të kalimit të së drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme, në ZVRPP, në përputhje me aktet ligjore”.

<sup>53</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>54</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

<sup>55</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

Ndërsa, në drejtim të konfliktit të interesit për çështje të shqyrtuara nga gjyqtarja Rezarta Aliu, ku si përfaqësues i palëve ka qenë avokati S. M., gjatë hetimit administrativ nuk u bë e mundur<sup>56</sup> të administrohej informacion. Për këtë arsye, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të jepte sqarime nëse ka shqyrtuar çështje gjyqësore, ku përfaqësues i palëve në proces të ketë qenë në cilësinë e avokatit shtetasi S. M., duke vërtetuar këto fakte me dokumente shkresore, ashtu sikurse dorëheqjen e saj në raste të tilla. Në parashtrimet e saj, subjekti deklaroi se asnjëherë nuk i është caktuar dhe, aq më tepër, të ketë gjykuar ndonjë çështje gjyqësore, ku përfaqësues i palëve ndërgjyqëse të ketë qenë shtetasi S. M.. Këto deklarime subjekti i ka vërtetuar me dokumente shkresore të paraqitura bashkëlidhur me parashtrimet<sup>57</sup>.

**2) Kredi bankare, datë 23.3.2016, mare nga “Raiffeisen Bank” sh.a.,** për arsye personale (shlyerje e kredive të mëparshme, blerje automjeti dhe pagesë pakete turistike gusht 2016), shuma 1,200,000 lekë, norma efektive e interesit 13.36% në vit, për vitin e parë të kredisë, afati 36 muaj (25.3.2016 – 25.3.2019), kësti mujor 39,966.16 lekë/muaj. Shuma e detyrimit të mbetur pa shlyer 942,696.20 lekësh, në janar të vitit 2017, sipas planit të shlyerjes bashkëngjitur kontratës së kredisë. Sipas vërtetimit bankar datë 30.1.2017, shuma në fund të vitit 2016 është 972,780.53 lekë.

Nga aktet në dosje<sup>58</sup> konstatohet se me kontratë kredie bankare të datës 23.3.2016, shtetasit Rezarta dhe E. A., kanë marrë në “Raiffesen Bank” kredi në shumën 1,200,000 lekë, për arsye personale, me afat 36 muaj, e cila është disbursuar në datën 25.3.2016. Kjo kredi është deklaruar me të njëjtat terma nga subjekti në DPV-të e viteve 2016 dhe 2017, duke deklaruar shumat e detyrimit të shlyer dhe të mbetur. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kësteve për vitin 2016, pasi rezultati financiar i këtij viti është pozitiv.

**3) Mastercard “Raiffeisen Bank” sh.a.,** datë 7.3.2013 e rinovuar në vitin 2015, shuma 150,000 lekë. Afati i vlefshmërisë 36 muaj, e pashlyer. Detyrimi në datën 30.12.2016, shuma 151,042 lekë, verifikuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2017, të “Raiffeisen Bank”.

**4) Marrëveshje siguroese (me bllokim depozite) nr. \*\*\*, datë 8.9.2015,** në favor të BKT-së për garantimin e kontratës së kredisë bankare e lehtësuar për blerje apartamenti nr. \*\*\*, datë 19.9.2012. Gjendja e depozitës në datën 23.1.2017 është 223,267.20 lekë, ku përfshihen interesat vjetore të vitit 2016. Gjendja e kredisë në vlerën 4,494,095.28 lekë.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se sipas marrëveshjes siguroese (me bllokim depozite) nr. \*\*\*, datë 8.9.2015<sup>59</sup>, dorëzanësat Rezarta Aliu (Paja) dhe E. A. kanë vendosur si garanci për kredinë e marrë nga znj. H. P., depozitën në emër të znj. Rezarta Aliu (Paja) në shumën 200,000 lekë<sup>60</sup>, ndërsa gjendja e depozitës dhe e kredisë konfirmohen nga të dhënat bankare të vëna në dispozicion nga BKT-ja, sipas deklarimeve të subjektit.

## **Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur E. A. - bashkëshorti**

<sup>56</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Durrës në dosjen e Komisionit.

<sup>57</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2021, të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, bashkëlidhur saj, kërkesa për informacion nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2021, shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.4.2021, për dhënie informacioni nga sekretaria gjyqësore dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021, nga kancelaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>58</sup> Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>59</sup> Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>60</sup> Kjo depozitë rrjedh nga kalimi i depozitës në vlerën prej 500,000 lekësh nga z. S. M. te subjekti, trajtuar më sipër.

Bashkëshort i subjektit të rivlerësimit, z. E. A., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, dhe ka deklaruar:

1. Automjet tip “Mercedes-Benz \*\*\*”, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 2001, sipërtrajtuar.
2. Automjet tip “Mercedes-Benz \*\*\*”, me targa \*\*\*, prodhim i vitit 1993, sipërtrajtuar.
3. Kontratë depozite bankare në shumën 220,000 lekë, në BKT, datë 5.8.2015, e vendosur si garanci e kredisë bankare e lehtësuar për blerje apartamenti nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, sipërtrajtuar.
4. Veprim juridik, datë 12.10.2016, për shitblerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, nr. shasie \*\*\*, viti i prodhimit 1998, shitur për pjesë këmbimi. Shitësi E. R. A.. Vlera: 130,000 lekë. Pjesa takuese: bashkëpronësi bashkëshortore ½ pjesë.

Gjatë hetimit administrativ nga aktet në dosje<sup>61</sup> ka rezultuar se me veprim juridik të datës 12.10.2016, z. E. A. i ka shitur shtetasit Gj. T. për pjesë këmbimi automjetin me nr. shasie \*\*\*, në çmimin 135,000 lekë, i cili i ka kaluar atij në rrugë bankare nga llogaria e shtetasës M. D., nëpërmjet “Raiffeisen Bank”, në datën 20.10.2016<sup>62</sup>. Ky veprim është deklaruar saktësisht nga subjekti në DPV-në e vitin 2016. Këtë automjet bashkëshorti i subjektit e kishte blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 15.10.2008, në shumën 5,500 euro, para martesës dhe para emërimit në detyrë të subjektit, me të ardhura të ligjshme<sup>63</sup>.

### **Detyrime financiare**

Bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të njëjtat detyrime financiare si dhe subjekti, trajtuar më sipër.

## **KONSTATIME TË TJERA**

### **1. Në lidhje me adresat e banimit**

**1.1.** Në deklaratën *Vetting* në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni regjistruar në gjendjen civile” subjekti ka deklaruar adresën “Rr. ‘S. D.’ \*\*\*, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë”.

ILDKPKI-ja, për këtë adresë, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar: (i) të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në këtë adresë; (ii) të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në këtë adresë; (iii) të kenë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në këtë adresë.

Gjatë hetimit administrativ nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, në lidhje me adresën “Rr. ‘S. D.’ \*\*\*, p. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë”, rezultoi se: (i) në DPFD e vitit 2009 – DPV 2017 subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën “Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë, rr. ‘S. D.’, Pallati i P. F.e, nr. \*\*\*, shk. \*\*\*”; (ii) subjekti nuk ka deklaruar ndonjë pasuri në pronësi apo përdorim në këtë adresë, qoftë në deklaratën *Vetting*, qoftë në deklaratimet periodike që prej vitit 2009; (iii) në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar, ndër të tjerash, edhe një banesë të ndodhur në Njësinë Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë, Rr.”M. Gj.”, Pallati i P. F., shk.\*\*\*, kati \*\*\*, e përdorur për periudhën nëntor 2006 – 20.11.2012, si banesë e marrë me qira nga nëna e saj H. P., prej shtetasve H. dhe A. M., duke sqaruar se nuk disponon dokument qiraje, por ka paraqitur: vërtetimin e ZGJC-së, Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë, datë 28.1.2020, deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 28.1.2020, të

<sup>61</sup> Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>62</sup> Kjo çështje është trajtuar gjithashtu në pikën 7.2. të vendimit.

<sup>63</sup> Rezultuar nga analiza financiare e babait të tij R. A., për periudhën 1994 – 2008, kur bashkëshorti i subjektit ka qenë pjesë e familjes së origjinës. Shihni pikën 1.5. të rubrika “Konstatime të tjera”.

lëshuar nga shtetasit H. dhe A. M.; si dhe vërtetim nga dokumentet hipotekore, me të cilat vërtetohen deklaratimet e subjektit.

Po kështu, nga verifikimi i detyrave të ushtruara nga subjekti, referuar raportit profesional dhe deklaratimeve periodike, rezultoi se: (i) në periudhën shtator 2008 – janar 2009 subjekti ka kryer stazhin profesional, në detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; në periudhën 7.1.2009 – 31.12.2010 ka punuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) në periudhën janar 2011 – 2017, ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Pra, në periudhën në fjalë, nëntor 2006 – 20.11.2012, ka qenë me detyrë në Tiranë dhe Përmet, dhe duke qenë se nuk ka qenë e martuar ka banuar në banesën e marrë me qira nga nëna e saj pikërisht “*Njësia Bashkiake Nr. \*\*\* Tiranë, rr. ‘M. Gj.’*”. Nga verifikimi në *google map*, rruga “M. Gj.”, deklaruar në pyetësin standard dhe rruga “S. D.”, deklaruar në deklaratën *Vetting*, janë shumë pranë njëra-tjetrës, dhe ky duket të jetë shkak që emri i rrugës në deklaratën *Vetting* nuk përputhet me rrugën e pasurisë së marrë me qira nga nëna e subjektit. Veç kësaj, nga verifikime dhe burime të çdolloji nuk u evidentuan të dhëna a dyshime për pasuri të subjektit të rivlerësimit e personave të lidhur me të në të dyja adresat e sipërpërmendura.

Gjatë hetimit administrativ u kërkua informacion për çështje të shqyrtuara në drejtim të konfliktit të interesit dhe procedime penale të shtetasve H. dhe A. M., nga ku nuk rezultuan çështje të shqyrtuara<sup>64</sup> nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë këta shtetas apo procedime penale në emër të tyre<sup>65</sup>.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të kësaj banese në DPV-të përkatëse, dhe në parashtrimet e saj, znj. Rezarta Aliu ka sqaruar se ka banuar në këtë banesë si pjesë e familjes dhe në asnjë rast nuk ka gëzuar të drejta reale mbi këtë pasuri. Pavarësisht faktit se pasuria realisht ishte marrë me qira nga nëna e saj, sipas parashikimit të gremës “a”, të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, subjekti duhet të deklaronte përdorimin. Por, në përfundim të procesit, modeklarimi u çmua nga Komisioni si pasaktësi e llojit formal dhe pa pasoja, që nuk penalizon subjektin e rivlerësimit. Për të arritur në këtë përfundim, përveç faktit që nuk ka pasur dyshime e të dhëna për lidhje të subjektit me këtë pasuri, Komisioni çmoi edhe deklaratimet e detajuara në pyetësin standard në lidhje me çdo pasuri të përdorur prej saj, qoftë edhe në periudha të shkurtra kohore, për të gjithë periudhën e kërkuar.

**1.2** Në lidhje me adresën “lagjja nr. \*\*\*, rr. ‘E.’ p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës”, deklaruar si adresë vendqëndrimi në deklaratën *Vetting*.

ILDKPKI-ja, për këtë adresë, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar: (i) të ketë në pronësi pasuri të paluajtshme në këtë adresë; (ii) të ketë marrë me qira pasuri të paluajtshme në këtë adresë; (iii) të kenë në posedim ose në përdorim pasuri të paluajtshme në këtë adresë.

Gjatë hetimit administrativ, nga verifikimi i deklaratimeve të subjektit, rezultoi se: (i) në DPV-të e viteve 2016 dhe 2017 subjekti ka deklaruar si vendqëndrim tjetër këtë adresë, pra, “*lagjja nr. \*\*\*, rr. ‘E.’, p. \*\*\* (\*\*\*) ‘T.’, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës*”; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë pasuri në pronësi apo përdorim në këtë adresë, si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklaratimet periodike; (iii) në përgjigjet e pyetësit nr. 1, subjekti ka deklaruar se banesa e ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, rruga “E.”, p. nr. \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Durrës, është në pronësi të prindërve dhe vëllait të bashkëshortit, të cilën e ka përdorur pa paguar qira, për shkak të martesës ligjore me bashkëshortin E. A.. Subjekti ka paraqitur vërtetim nga dokumentet

<sup>64</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës në dosjen e Komisionit.

<sup>65</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

hipotekore, lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, në datën 22.6.2012, nga ku rezulton se ky apartament është përfituar nga shtetasi R. A. sipas kontratës së privatizimit të datës 22.12.1993, në vlerën 21,317 lekë dhe është regjistruar si pasuria nr. \*\*\*, me sip. 90.32 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasve R., M. dhe A. A.. Ky apartament është shitur sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 26.8.2019, në shumën 49,676 euro.

Me qëllim evidentimin e ndonjë lidhjeje të subjektit me këtë pasuri, i pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi ndonjë shtesë të këtij apartamenti apo investim të kryer duke vërtetuar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, znj. Rezarta Aliu ka sqaruar se:

Së pari, në lidhje me investime të kryera në këtë pasuri, me vendimin nr. 8, datë 21.12.2001, të Këshillit të Rregullimit të Territorit Bashkia Durrës është dhënë leja e ndërtimit për shtesë anësore të pallatit nr. \*\*\* me afat kohor deri më 30.10.2003, legalizuar në emër të vjehrrit të saj z. R. A. me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 25.9.2020, me sip. ndërtimi 63 m<sup>2</sup> për banim. Regjistrimi i saj është bërë në datën 7.12.2020 dhe po në këtë datë është lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie që i përket kësaj pasurie.

Së dyti, në lidhje me vlerën e investimit, referuar preventivit përkatës, shpenzimet totale për shtesën anësore të pallatit pesëkatësh me nr. \*\*\*, arrinin shumën 2,535,010 lekë, ndërkohë nga kjo shumë vjehrrit i saj z. R. A. i ka paguar shoqërisë ndërtuese “S.” sh.p.k. pjesën e tij takuese prej 500,000 lekësh, referuar mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 17.5.2002.

Së treti, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti ka deklaruar se ajo është siguruar nga kursimet familjare si rezultat i punës së secilit anëtar të familjes së bashkëshortit të saj deri në vitin 2001.

Për të mbështetur pretendimet e saj dhe të ardhura të ligjshme të prindërve të bashkëshortit, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore, bazuar në të cilat, Komisioni kreu analizën financiare pasqyruar në tabelën më poshtë, nga ku rezultoi se z. R. A. dhe familja e tij, kanë pasur mjftueshëm të ardhura të ligjshme për pagesën prej 500,000 lekësh, e cila është pjesa e tyre takuese për ndërtimin e shtesës.

<b>Familja e prindërve të bashkëshortit</b>	<b>Periudha 1994 – 17.5.2002</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>5 421 725</b>
Të ardhura nga pagat E. A.	495 143
Të ardhura nga pagat R. A.	1 059 833
Të ardhura nga biznesi R. A.	2 224 000
Të ardhura nga paga M. A.	1 642 749
<b>Shpenzimet</b>	<b>4 871 085</b>
Shpenzimet e jetesës (për 3 persona) <sup>66</sup>	3 271 085
Paguar për shtesën e apartamentit në Durrës	500 000
Dhënë hua te një person fizik nga R. A. në vitin 2002	1 100 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>550 641</b>

Analiza është kryer duke përdorur metodologjinë kumulative deri në momentin e pagesës së shumës 500,000 lekë për shtesën e ndërtuar mbi apartamentin e fituar me privatizim, duke u

<sup>66</sup> Përbërja familjare e bashkëshortit të subjektit E. A. është 3 persona dhe përfshin atë bashkë me prindërit e tij.



konsideruar të ardhurat nga: (i) pagat e prindërve R.<sup>67</sup> dhe M. A.<sup>68</sup>; (ii) pagat e z. E. A.<sup>69</sup> deri në fund të vitit 2012<sup>70</sup>; (iii) nga aktiviteti privat i personit fizik “R. A.”-avokat, regjistruar në vitin 1994<sup>71</sup>, duke përllogaritur një marzh fitimi në masën 80%, bazuar në praktikën e ndjekur nga Komisioni për profesionin e avokatit<sup>72</sup>.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në të gjitha provat e administruara më sipër, nuk rezultuan lidhje të subjektit me këtë pasurinë në Durrës, referuar fakteve si vijojnë: (i) pasuria apartament banimi në Durrës, me nr. \*\*\*, me sip. 90.32 m<sup>2</sup>, është përfutur nga prindërit e bashkëshortit sipas kontratës së privatizimit të datës 22.12.1993, në vlerën 21,317 lekë dhe është regjistruar përpara se subjekti të ishte subjekt deklarimi dhe të ishte martuar me djalin e tyre; (ii) në vitin 2001 për këtë apartament është miratuar leja e ndërtimit në emër të z. R. A. për shtesë anësore me sip. 63 m<sup>2</sup>, me afat deri në vitin 2003, pra përpara se subjekti të ishte subjekt deklarimi dhe të ishte martuar, shtesë e cila është legalizuar e më pas është regjistruar në vitin 2020, në emër të shtetasit R. Al.; (iii) nuk është konstatuar asnjë transaksion bankar midis subjektit dhe bashkëshortit dhe shtetasve R. dhe M. A., si dhe nuk ka asnjë dokument shkresor që të vërtetojë kryerjen e veprimeve nga subjekti apo bashkëshorti për marrjen e lejes së ndërtimit apo procedurat e legalizimit dhe regjistrimit të shtesës; (iv) nuk janë konstatuar kontrata me FSHU-në dhe UKT-në në emër të subjektit apo bashkëshortit në Durrës; (v) babai i bashkëshortit të subjektit dhe familja e tij kanë pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të kryer investimin në shtesën e apartamentit ekzistues, në vlerën 500,000 lekë.

**1.3.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar se për shkak të ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Përmet për më shumë se 7 vjet, ka banuar në një banesë të ndodhur në Përmet, lagjja “V.”, në pronësi të shtetasit Dh. E. pa paguar qira, pasi qëndrimi në këtë banesë ka qenë me ditë të caktuara, për arsye pune. Pretendimet e tij, subjekti i ka vërtetuar me deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2020, të shtetasit Dh. E. dhe vërtetim nga dokumentet hipotekore të pasurisë nr. \*\*\*, datë 19.9.2012, në emër të këtij shtetasi. Ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se kjo banesë i është dhënë për të banuar nga shtetasi Dh. E., me qëllim mirëmbajtjen e saj, për shkak të kushteve në të cilat ndodhej banesa dhe pamundësisë së tij për t’u përkujdesur për të, si dhe për shkak të faktit se vlera e qirasë në Përmet, në vitin 2011, si dhe kërkesat për banesë me qira ishin të papërfillshme. Subjekti ka paraqitur edhe një tjetër deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 30.1.2021, lëshuar nga shtetasi Dh. C. E., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

Për këtë shtetas janë kryer hetime lidhur me konfliktin e interesit dhe përfshirjen e tij në veprimtari kriminale, nga ku nuk kanë rezultuar procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga

<sup>67</sup> Vërtetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021, nga ISSH-ja, e cila ka bashkëlidhur dosjen e pensionit nr. \*\*\* të z. R. A..

<sup>68</sup> Dosja e plotë pensionit nr. \*\*\*, datë 6.2.2008, e cila përmban vërtetimet e ISSH-së për pagën e znj. M. A. nga viti 1994 deri në marrjen e pensionit, si dhe masën e pensionit ndër vite; vërtetim nr. \*\*\*, datë 29.1.2021, nga ISSH-ja Durrës për të ardhurat nga pensioni për vitet 2008 – 2020.

<sup>69</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.11.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për vitet 1994 - 1996; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, nga KESH për vitet 2001-2002; vërtetim për bazën e vlerësueshme nga ISSH-ja për vitet 2006-2007; vërtetim nr. \*\*\*, datë 5.12.2016 për periudhat 28.2.2008-13.9.2009 dhe 8.11.2011 – 15.11.2014; vërtetim nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, nga QNOD për vitet 2010-2011.

<sup>70</sup> Subjekti është martuar me bashkëshortin në shkurt të vitit 2013, duke u shkëputur kështu nga familja e tij e origjinës.

<sup>71</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 31.12.2019, nga DRT-ja Durrës; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2021, nga DRT-ja Durrës; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2021, nga Bashkia Durrës.

<sup>72</sup> Shihni vendimin nr.\*\*\*, datë 4.7.2019 (V. S.), nga Komisioni; vendimin nr. \*\*\*, datë 4.6.2020 (E. Sh.); vendimi nr. \*\*\*, datë 11.10.2019 (T.); vendimi nr. \*\*\*, datë 27.9.2019 (H.).

gjqqtarja Rezarta Aliu me palë shtetasin Dh. E.<sup>73</sup> apo procedime penale të regjistruara në emër të tij<sup>74</sup>.

**1.4** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se gjatë kohës që ka ushtruar detyrën në Përmet ka banuar në një banesë në lagjen “E Re”, në pronësi të shtetasve A. dhe M. M., me ditë të caktuara, për arsye pune dhe se për periudhën janar 2012 – qeshor 2014 ka paguar qira në vlerën 2,000 lekë/muaj. Për periudhën mars 2015 – maj 2018 ka paguar qira vlerën 3,000 lekë/muaj. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 25.1.2020, të shtetasve A. dhe M. M. dhe një certifikatë për vërtetim pronësie të pasurisë nr. \*\*\*, datë 27.2.2019, në emër të tyre.

Gjatë hetimit administrativ, në lidhje me këta shtetas janë kryer hetime mbi konfliktin e interesit dhe përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, nga nuk kanë rezultuar procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë këta shtetas<sup>75</sup> apo procedime penale të regjistruara në emër të tyre<sup>76</sup>.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime për mosdeklarimin e përdorimit të kësaj banese dhe asaj të përshkruar në pikën 1.3. më sipër, në DPV-të përkatëse. Në parashtrimet e tij, subjekti ka sqaruar se këto banesa janë mbajtur prej saj për arsye pune dhe se janë përdorur në ditë të caktuara e jo në mënyrë të vazhdueshme. Sipas znj. Rezarta Aliu, këto banesa nuk kanë qenë në asnjë moment në përdorimin e saj, sipas parashikimit që Kodi Civil i jep veprimit juridik të “përdorimit të sendit”. Pavarësisht këtyre shpjegimeve sipas ligjit, subjekti ka pasur detyrimin për deklarimin e përdorimit të pasurive. Por, referuar faktit që pasuritë janë përdorur përkohësisht nga subjekti dhe nuk rezultoi që të ketë fshehur ndonjë fakt a rrethanë në lidhje me këto pasuri, pronësia e të cilave u vërtetua në emër të shtetasve të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni e çmoi modeklarimin e përdorimit si pasaktësi të llojit formal dhe pa pasoja.

**1.5.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se ka qëndruar në mënyrë sporadike me ditë të caktuara dhe çdo javë, në një banesë të ndodhur në Selitë Tiranë, me vendndodhje në rrugën “R. Sh.”, p. “S.”, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, R. dhe M. A.. Subjekti ka paraqitur certifikatën nr. \*\*\*, për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 30.12.2015, nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë për pasurinë nr. \*\*\*, me pronare nënën e bashkëshortit, M. M. A..

Me kërkesë të Komisionit, ASHK Tirana Rurale <sup>177</sup>, informoi se znj. M. A. ka pasur të regjistruar pasurinë nr. \*\*\*, apartamentin me sip. 58.84 m<sup>2</sup> në Selitë Tiranë, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 21.12.2015, në vlerën 35,750 euro, e paguar sipas përcaktimeve të kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 25.3.2010 nga porositësja V. Ll.. Më tej, shtetasja M. A. e ka shitur këtë pasuri me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 4.8.2018, shtetasit I. I..

Duke qenë se kjo pasuri është deklaruar në përdorim, edhe pse në mënyrë sporadike, me qëllim evidentimin e çdolloj lidhje të subjektit me këtë pasuri apo dhe pronësisë së mundshme mbi të, gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentin e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie, të vërtetojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj, si dhe të paraqesë librezat e furnizimit me energji dhe ujë të saj, për të cilat subjekti është

<sup>73</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>74</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

<sup>75</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>76</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK-u në dosjen e Komisionit.

<sup>77</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2020, nga ASHK Tirana Rurale 1, në dosjen e Komisionit.

përgjigjur në mënyrë të detajuar duke vënë në dispozicion dokumente shkresore për të vërtetuar çdo pretendim<sup>78</sup>. Konkretisht:

Së pari, në lidhje me mënyrën e fitimit të pronësisë, subjekti ka informuar se fillimisht kontrata e sipërmarrjes për këtë pasuri ishte lidhur mes sipërmarrësit dhe shtetases V. Ll. në datën 25.3.2010, e cila më pas e kishte zgjidhur atë, duke ia kaluar të gjitha të drejtat dhe detyrimet, përfshirë edhe pagimin e çmimit 35,750 euro shtetasit R. A. (vjehtëri i subjektit). Sipas subjektit, ky i fundit, kishte kryer tri pagesa në shumat 20,000 euro, 6,400 euro dhe 2,000 euro, përkatësisht në vitet 2010 dhe 2011, vërtetuar me mandatpagesa. Ndërsa, shumat prej 1,850 euro dhe 5,500 euro janë paguar *cash*, përkatësisht, në fillim të vitit 2012 dhe në ditën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, datë 22.11.2015. Për të mbështetur pretendimet e tij, subjekti ka paraqitur dokumente shkresore<sup>79</sup>.

Së dyti, në lidhje me burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar se burojnë nga kursimet familjare, ndër vite, si vijojnë: (i) të ardhurat nga puna e vjehtërit si avokat dhe pensioni i pleqërisë; (ii) të ardhura të vjehtërit në arsim dhe nga pensioni i pleqërisë; si dhe (iii) të ardhura të bashkëshortit të saj në organe të ndryshme të administratës publike, duke paraqitur dokumente shkresore, sikurse është trajtuar në pikën 1.2. të konstatimeve të tjera, më sipër.

Komisioni ka kryer analizën financiare me të dhënat që dispononte duke përdorur metodologjinë kumulative për periudhën 1994 – 2015, vit kur është paguar kësti i fundit për blerjen e këtij apartamenti në Tiranë. Nga kjo analizë rezultoi se familja e bashkëshortit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar këtë pasuri.

<b>Familja e prindërve të bashkëshortit</b>	<b>Periudha 1994 – 2015</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>15 592 687</b>
Të ardhura nga pagat E. A. (deri në vitin 2012)	4 433 873
Të ardhura nga pagat dhe pensionet R. A.	2 439 396
Të ardhura nga biznesi R. A.	4 608 000
Të ardhura nga paga dhe pensione M. A.	3 250 278
Mbartur nga periudha të kaluara (periudha 1994 – 17.5.2002)	550 641
Kredi nga “Raiffeisen Bank” E. A.	310 500
<b>Shpenzimet</b>	<b>14 807 191</b>
Shpenzimet e jetesës <sup>80</sup>	5 023 981
Blerë truall dhe shtëpi në Durrës në vitin 2003	4 000 000

<sup>78</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

<sup>79</sup> Kontratë porosie sipërmarrje ndërtimi (apartament banimi) nr. \*\*\*, datë 25.3.2010, lidhur midis shtetasit Q. H. J. në rolin e sipërmarrësit dhe shtetases V. Ll. në rolin e porositëses; mandatkëtim datë 4.8.2010, për shumën 20,000 euro; mandatkëtim pa datë për shumën 6,400 euro; mandatkëtim datë 25.1.2011 për shumën 2,000 euro; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, lëshuar në datën 1.2.2021, nga administratori i shoqërisë “T.” sh.p.k. z. Q. J.; vendim nr. \*\*\*, datë 23.4.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendim nr. \*\*\*, datë 14.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; aktmarrëveshje nr. \*\*\*, datë 26.4.2012, lidhur midis shoqërisë “T.” sh.p.k., shoqërisë “S.” sh.p.k. dhe z. R. X., e njehsuar me origjinalin sipas vërtetimit nr. \*\*\* rep., datë 1.2.2021, të noterit L. E. Sh. (K.) e Dhomës Vendore të Noterisë Tiranë; kontratë e shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 21.12.2015, bashkëlidhur certifikatës për vërtetim pronësie për pasurinë me nr. pasurie \*\*\*, e regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. nr. \*\*\*, S. Tiranë, lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë në datën 14.10.2015; bashkëlidhur kartelë e pasurisë së paluajtshme; kontratë porosie sipërmarrje ndërtimi (apartament banimi) nr. \*\*\*, datë 25.3.2010; deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 1.12.2015; kontratë bashkëpunimi në investim dhe sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 28.4.2007; planimetria e kompleksit; planimetria e apartamentit; kontrata nr. \*\*\*, datë 4.8.2018, “Për shitblerje pasurie të paluajtshme”, urdhërpagesë e datës 9.8.2018, nga Fibank për kalimin e shumës 38,000 euro nga noteri A. Xh. te shtetasi R. A..

<sup>80</sup> Shpenzimet e jetesës për 3 persona deri në vitin 2012, pas datës 14.2.2013, për 2 persona pasi djali i tyre E. A. është martuar me subjektin. Pagat e z. E. A. janë konsideruar për të njëjtën periudhë me shpenzimet e jetesës.

Blerë apartamenti në Tiranë (paguar në vitet 2010 – 2015)	4 954 670
Paguar kredia në “Raiffeisen Bank”	150 949
Blerë automjet nga E. A. në vitin 2008	677 504
Ndryshim likuiditetesh	88
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>785 496</b>

Së treti, subjekti ka sqaruar se librezat e energjisë elektrike të apartamentit, fillimisht, ka qenë në emër të porositëses V. Ll. dhe pas blerjes në vitin 2015 nga znj. M. A., librezat ka dalë në emër të saj. Pas shitjes në vitin 2018, librezat ka kaluar në emër të blerësit I. I., ndërsa librezat e ujit ka dalë në emër të investitorit të ndërtimit të godinës z. R. X. dhe nuk ka ndryshuar deri sot. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur librezën e energjisë elektrike në emër të shtetasit I. I. dhe librezën e ujit në emër të investitorit R. X..

Gjatë hetimit administrativ u kryen hetime mbi ndonjë konflikt të mundshëm interesi, nga ku nuk kanë rezultuar procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë pjesëmarrëse shoqëritë “S.” sh.p.k., “T.” sh.p.k. dhe shtetasen V. Ll.<sup>81</sup>. Po kështu, pas kërkesës së Komisionit, shoqëria “S.” sh.p.k.<sup>82</sup> informoi se mes shoqërisë “S.” sh.p.k. dhe shtetasve Rezarta dhe E. Aliu nuk ka kontrata apo veprime juridike.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u evidentuan lidhje të subjektit me këtë pasuri, referuar fakteve si vijojnë: (i) kjo pasuri është prenotuar që në vitin 2010 nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. R. A., i cili ka kryer pagesat përkatëse për blerjen e saj në vitet 2010 dhe 2011, kur subjekti ende nuk ishte martuar; (ii) kontrata e shitblerjes është lidhur në vitin 2015 dhe pasuria është regjistruar në emër të znj. M. A., pasuri e cila i është shitur në vitin 2018 shtetasit I. I., në çmimin 38,000 euro, transferuar në llogari të z. R. A.; (iii) nuk janë lidhur kontrata me FSHU-në dhe UKT-në dhe as kontrata të çdolloji tjetër në lidhje me këtë pasuri në emër të subjektit apo bashkëshortit të saj; (iv) nuk është konstatuar asnjë transaksion bankar midis subjektit dhe prindërve të bashkëshortit, që të kenë lidhje me këtë pasuri; (v) prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar çmimin e blerjes së kësaj pasurie, nga i cili, vetëm pjesa prej 5,500 euro është paguar në vitin 2015, në kohën kur subjekti ka qenë në martesë ligjore me djalin e tyre.

2. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar se ka marrë “hua nga një person fizik në shumën 100,000 lekë, me transfertë bankare datë 12.5.2014, në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank” sh.a.”. Shuma e shlyer 100,000 lekë. Detyrimi i mbetur 0 (zero).

Këtë hua subjekti e ka deklaruar edhe në pyetësin nr. 1, duke sqaruar se është përdorur në datën 20.5.2014 për shlyerjen e një pjese të huas prej 500,000 lekësh, marrë nga shtetasi S. M. në datën 29.6.2012. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë së pagës së subjektit në “Raiffeisen Bank” është evidentuar se në datën 12.5.2014, ka kaluar shuma 100,000 lekë, me urdhërues znj. E. C. (N.). Kjo shumë është tërhequr me pjesë nga data 12.5.2014 deri më 20.5.2014, kur është përdorur për t’ia dhënë shtetasit S. M., sikurse është deklaruar nga subjekti.

Në lidhje me gjeneralitetet e saj dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënëses E. C. (K.), në përgjigje të pyetësit nr. 2<sup>83</sup>, subjekti ka sqaruar se është magjistrate dhe se mbiemri K. dhe emri N. janë thjesht gabime materiale. Në analizë të dokumenteve shkresore të paraqitura, rezultoi se: (i) mbiemrat C. dhe K. janë përkatësisht të vajzërisë dhe pas martesës për huadhënësen; (ii) znj. E. C./K. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien

<sup>81</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>82</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2021, nga shoqëria “S.” sh.p.k. në dosjen e Komisionit.

<sup>83</sup> Vërtetim page E. C./K. nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; certifikatë martesë datë 20.1.2021; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” sh.a. për periudhën 1.1.2014 – 12.5.2014.

e huas në vlerën 100,000 lekë në datën 12.5.2014<sup>84</sup> dhe, për rrjedhojë, kjo shumë u konsiderua si e ardhur e ligjshme në analizën financiare.

Për sa i takon kthimit të kësaj huaje brenda vitit 2014, nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e saj, pasi rezultati financiar i këtij viti është pozitiv.

**3.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar kontratë kredie bankare të lidhur në datën 20.7.2009, midis “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., shtetases Rezarta Paja dhe dorëzanës E. C., kredi në shumën 400,000 lekë (për shpenzime dasme për motrën e saj E. P.), afati i shlyerjes 36 muaj.

Nga verifikimi i deklaramëve të subjektit, konstatohet se:

a. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar kredinë në shumën 613,181,28 lekë, me afat shlyerje 5 vjet, por pa specifikuar bankën. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi bankën në të cilën është marrë kjo kredi dhe qëllimin e marrjes së saj, subjekti ka sqaruar<sup>85</sup>, sikurse në pyetësin nr. 1 se është marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a. për shpenzimet e ceremonisë martesore të motrës E. P.. Më tej ka sqaruar se në DVP-në e vitit 2009 ka deklaruar kredi në shumën 613,181,28 lekë, ku përfshihet shuma fillestare e kredisë prej 400,000 lekësh, si dhe interesat që do të paguheshin. Subjekti ka paraqitur kontratën e kredisë bankare, datë 20.7.2009, marrë në “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a.

b. Në DPV-në e viteve 2010 dhe 2011, subjekti ka deklaruar këstet për shlyerjen e kësaj kredie.

c. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar që kredia është shlyer tërësisht në mars të vitit 2012 me të ardhura të kursyera nga paga.

Nga dokumentet e administruara<sup>86</sup> rezultoi se kredia është disbursuar në datën 21.7.2009 dhe është shlyer me këste mujore deri më 9.2.2012, kur është shlyer tërësisht me depozitim të shumës prej 210,000 lekësh në këtë datë dhe shumës 37,000 lekë, në datën 22.2.2012.

Sa i takon të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e shumës 210,000 lekë, depozituar në datën 9.2.2012, nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të bërë këtë depozitim, për shkak të balancës negative prej 151,571 lekësh, pasqyruar në tabelën vijuese.

<b>Përshkrimi</b>	<b>1.1.2012 – 9.2.2012</b>
<b>Pasuritë</b>	<b>211 834</b>
Derdhur tek “Intesa Sanpaolo Bank” (për të shlyer kredinë 400,000 lekë)	210 000
<i>Shtesa /pakësime/likuiditete</i>	<i>1 834</i>
Gjendja e likuiditeteve	-60 286
<b>Të ardhurat</b>	<b>182 307</b>
Paga e subjektit (pa dietat)	148 161
Të ardhura nga toka bujqësore <sup>87</sup>	34 146
<b>Shpenzimet</b>	<b>122 044</b>
Shpenzime jetike për 4 persona	61 172
Shpenzime transporti	4 033

<sup>84</sup> Të ardhurat e znj. E. C./K. për periudhën tetor 2009 – 12.5.2014 janë 4,292,305 lekë, ndërsa shpenzimet për një person për të njëjtën periudhë janë 672,350 lekë.

<sup>85</sup> Shihni përgjigjet e pyetjeve të datës 17.2.2021 në dosjen e Komisionit.

<sup>86</sup> Shihni dosjen e ILDKPKI-së aneksi \*\*\* dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020, të “Intesa Sanpaolo Bank”, në dosjen e Komisionit.

<sup>87</sup> Janë konsideruar të ardhura nga toka bujqësore në 6/7 pjesë takuese.

Shlyerje këste të kredisë në “Raiffeisen Bank”	12 339
Shlyer këste kredie tek “Intesa Sanpaolo Bank”	10 500
Shpenzime qiraje (sipas pyetësorit standard)	34 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-151 571</b>

Ndërsa sa i takon shumës 37,000 lekë, e depozituar më 22.2.2012, nga verifikimet e kryera rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme<sup>88</sup>. Kështu, në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të depozituar shumën 210,000 lekë, në datën 9.2.2012, për shkak të një balance negative prej -151 571 lekësh. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi. Në prapësimet e tij, subjekti sqaroi se shuma e depozituar në datën 9.2.2012, rrjedh nga kursimet e realizuara nga paga e saj gjatë vitit 2011 sikurse është deklaruar në DPV-në e vitit 2011. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se ky pretendim qëndron<sup>89</sup> dhe, për këtë shkak, me rishikimin e analizës financiare, balanca negative kthehet në pozitive.

**4.** Nga informacioni bankar i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se gjatë periudhës 2007 – 2016, subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë marrë 18 (tetëmbëdhjetë) kredi, për të cilat në pyetësin standard subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara duke sqaruar se ato janë përdorur për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve personale dhe familjare. Pas verifikimit të çdo kredie dhe deklarimeve të subjektit, në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me këto kredi, rezultoi se: (i) deklarimet e subjektit për marrjen dhe shlyerjen e kredive përputhen me informacionin e administruar nga bankat; (ii) nga analiza financiare, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të shlyer kreditë gjatë periudhës 2009 – 2016<sup>90</sup>, pasqyruar në tabelën përmbledhëse përfundimtare.

Po kështu, u konstatua se subjekti ka kryer deklarime të pasakta në DPV-të për vitet 2015 dhe 2016, për dy kredi të marra në vitin 2015, përkatësisht në shumat 42,990 lekë dhe 52,990 lekë. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim dhe në parashtrimet e saj subjekti Rezarta Aliu ka sqaruar se mosdeklarimet kanë qenë pasaktësi, paqartësi apo harresë, të cilat nga Komisioni u konsideruan si pasaktësi në deklarime që nuk kanë sjellë pasoja, duke iu referuar shumave të vogla të kredive dhe faktit që marrja e kredive është një fakt lehtësisht i evidentueshëm dhe, për pasojë, mosdeklarimi nga subjekti në rastet kur ka ndodhur, nuk ka qenë me qëllim fshehjen e ndonjë fakti a veprimi të paligjshëm.

**5.** Në DPV-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar kursimet *cash* në shumën 500,000 lekë. Në deklarimet në vijim, deri në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar as shtesa as pakësime. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi periudhën e shpenzimit të kësaj shume dhe shpenzimet e mbuluara me këtë shumë, znj. Rezarta Aliu, ka sqaruar<sup>91</sup> se kursimet në shumën 500,000 lekë janë shpenzuar gjatë vitit 2015, kryesisht për shlyerjen e kredive bankare dhe për

<sup>88</sup> Subjekti ka tërhequr nga “Raiffeisen Bank” shumën 71,000 leke, nga data 2 - 22 shkurt, duke përdorur si burim *overdraftin*.

<sup>89</sup> Në DPV-në e vitit 2011, faqe 3, në rubrikën “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” në rreshtin e pestë të tabelës së deklarimeve, subjekti ka deklaruar të ardhura të kursyera nga paga dhe shpërblimet shuma 350,000 lekë, megjithëse nuk ka cilësuar se bëhet fjalë për gjendje *cash*. Kjo shumë e kursyer ka qenë gjendje *cash* në banesë dhe jo në bankë pasi gjendja e likuiditeteve në bankë, në fund të vitit 2011 ka qenë -62,120 lekë.

<sup>90</sup> Kur destinacioni i kredive është për blerje mallrash dhe shërbimesh si mallra elektronike elektroshtëpiake/automjet/pagesë pushimesh dhe shlyerje të kredive/haave të marra në periudha të mëparshme, vlera e këtyre mallrave/pagesave është përfshirë si shpenzim në analizën financiare.

<sup>91</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr.2 në dosjen e Komisionit.

shpenzime jetese<sup>92</sup>. Gjendja *cash* në shumën 500,000 lekë është pakësuar në analizën financiare të vitit 2015.

6. Në pyetësin nr.1, subjekti ka deklaruar se për shkak të ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, ka qëndruar atje me ditë të caktuara, duke specifikuar adresat e banimit në Përmet dhe çmimin e qirasë së paguar, i cili është përfshirë në analizën financiare si shpenzim. Gjithashtu, në po këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se ka qëndruar edhe në Përmet edhe në Tiranë. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës, ka deklaruar<sup>93</sup> se ka përdorur transportin publik, duke specifikuar çmimin e biletës dhe ndonjëherë ka udhëtuar me makinat e kolegëve të saj. Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime transporti kur ka qenë me lejelindje nga data 10.6.2014 – 2.3.2015, ndërkohë që ka saktësuar shpenzimet mujore të transportit në vlera mesatare, të cilat janë përfshirë në rubrikën shpenzime të analizës financiare<sup>94</sup>.

7. Nga verifikimi i të dhënave të regjistrimit noterial<sup>95</sup>, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Rezarta Aliu, bashkëshortin E. A. dhe prindërit e tyre, nuk rezultuan akte noteriale për blerje pasurish të luajtshme apo të paluajtshme të ndryshme nga ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit.

8. Nga verifikimi i të dhënave të DPPPP<sup>96</sup> në lidhje me subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin nuk rezultuan raportime për transaksione nga subjektet deklaruese.

9. Nga hetimi administrativ, përveç pasurive të deklaruara, nuk rezultuan<sup>97</sup> pasuri të tjera në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit dhe as kontrata të furnizimit me energji elektrike<sup>98</sup> dhe ujë<sup>99</sup>.

10. Përveç sa më sipër, gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me pasuri të tjera të luajtshme apo të paluajtshme të prindërve të bashkëshortit R. dhe M. A., e cila dha sqarime dhe paraqiti dokumente për dy pasuri të regjistruar në emër të këtyre shtetasve, nga analiza e te cilave rezultoi se: (i) pasuria nr. \*\*\* truall+ndërtesë është blerë nga shtetasi R. A. në vitin 2003, pra, përpara martesës së subjektit, ndërkohë që në vitin 2017 është miratuar leja e ndërtimit për shtimin e dy kateve dhe i gjithë dokumentacioni është përpiluar në emër të shtetasit R. A.; (ii) pasuria nr. \*\*\* truall + ndërtesë, përfituar nga shtetasi R. A. nga një procedurë ankandi e zhvilluar në vitin 2017 bazuar në titullin ekzekutiv, vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.11.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi me vendimin nr.\*\*\*, datë 14.4.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës. Në përfundim të hetimit administrativ, nuk u evidentuan lidhje të subjektit të rivlerësimit me këto dy pasuri.

## **Analiza financiare**

Në përfundim të hetimit administrativ, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni ka kryer analizën financiare për të gjithë periudhën e vlerësimit 2003 – 2016, e cila kishte rezultuar me një balancë negative totale në shumën - 594,881 lekë, për shkak të pamundësisë së familjes së origjinës së subjektit pjesë përbërëse e së cilës ka qenë deri në vitin 2013, për të paguar një pjesë të çmimit për blerjen e apartamentit të banimit në Y., Tiranë.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi është vlerësuar se subjekti e ka kundërshtuar barrën e provës, trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë vendim, rezultati financiar përfundimtar

<sup>92</sup> Shihni përgjigjen e pyetjes nr.7, pyetësin nr. 2.

<sup>93</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr.2 në dosjen e Komisionit.

<sup>94</sup> Shihni rubrikën “Metodologjia e përdorur”.

<sup>95</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.5.2020 nga Ministria e Drejtësisë, në dosjen e Komisionit.

<sup>96</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2020, nga DPPPP-ja, në dosjen e Komisionit.

<sup>97</sup> Shihni kthim përgjigjeje nga ASHK-ja vendore në dosjen e Komisionit.

<sup>98</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.5.2020, nga FSHU në dosjen e Komisionit.

<sup>99</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\*prot., datë 8.5.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

për të gjithë periudhën e rivlerësimit, ka ndryshuar si në tabelën më poshtë, analizë sipas të cilës subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar pasuritë dhe për të kryer shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri <i>neto</i> (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-5-3)
2009	-62 366	272 891	-335 257	1 112 261	1 054 179	393 338
2010	-2 688	-141 759	139 071	1 098 506	637 933	321 502
2011	352 934	-159 329	512 263	1 260 230	664 838	83 129
2012	5 824 643	5 018 462	806 181	2 202 008	969 292	426 535
2013	-95 129	-263 260	168 131	1 817 931	525 360	1 124 439
2014	521 191	-154 986	676 177	1 895 791	758 295	461 320
2015	-271 686	-382 041	110 355	2 062 554	1 082 829	869 370
2016	675 926	419 962	255 964	2 268 039	1 222 571	789 504
<b>Total</b>	<b>6 942 825</b>	<b>4 609 940</b>	<b>2 332 885</b>	<b>13 717 320</b>	<b>6 915 297</b>	<b>4 469 137</b>

### Metodologjia e përdorur gjatë analizës financiare

Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

#### Të ardhurat

- Të ardhurat nga punësimi të dokumentuara të subjektit përfshirë: bursën në Shkollën e Magjistraturës për periudhën para emërimit në detyrë<sup>100</sup>; pagat duke filluar nga data 7.1.2009 dhe deri në fund të periudhës së vlerësimit<sup>101</sup>. Subjekti është analizuar me familjen e saj të origjinës deri në fund të vitit 2012, ndërsa nga data e martesës e në vijim, është analizuar me bashkëshortin dhe fëmijën e tyre.
- Të ardhurat nga paga e bashkëshortit duke filluar nga data e martesës më 14.2.2013<sup>102</sup>. Bashkëshorti është analizuar me familjen e tij të origjinës deri në datën e martesës.
- Të ardhurat nga toka bujqësore në 6/7 pjesë të përfituara nga familja e origjinës së subjektit<sup>103</sup> nga tetori i vitit 2006 deri në momentin e martesës së subjektit.
- Të ardhurat nga shitja e automjetit të bashkëshortit sipas kontratës së shitblerjes dhe statement nga “Raiffeisen Bank”.

#### Shpenzimet

<sup>100</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 14.10.16 nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën tetor 2006 – 2008.

<sup>101</sup>Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga 7.1.2009 – 31.12.2010; vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet nga 1.1.2022 – 31.12.2016.

<sup>102</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.12.2016, nga Ministria e Punëve të Brendshme për periudhën 8.11.2011 – 15.11.2014; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2017, nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë për vitet 2015 – 2016; të ardhurat nga pagat janë verifikuar me lëvizjet e llogarisë së “Credins Bank”.

<sup>103</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Financës Bashkia Belsh mbi shlyerjen e taksës së tokës deri në vitin 2021; shkresë, datë 20.1.2021, e Bashkisë Belsh, sipas së cilës vërtetohet se të ardhurat vjetore nga tokat bujqësore, janë në shumën 363,512 lekë.



- Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur sipas përbërjes familjare dhe bazuar në standardin e ILDKPKI-së nga viti 2006 e në vijim: për periudhën tetor – dhjetor 2006 janë përlogaritur për 6 persona subjekti, nëna, dy vëllezër dhe dy motra; në vitin 2007 dy motrat e subjektit janë martuar/kanë nisur bashkëjetesën dhe në përbërjen familjare kanë qenë katër persona. Shpenzimet janë përlogaritur për katër persona deri në fund të vitit 2012.
- Shpenzimet e jetesës janë reduktuar në masën 40% për atë periudhë gjatë së cilës janë përfshirë të ardhura nga toka bujqësore për subjektin dhe familjen e saj të origjinës.
- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Shpenzimet e qirasë janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit të mbështetura me deklaratat noteriale nga qiradhënësit.
- Janë përfshirë si shpenzime blerjet e mallrave të ndryshme, nëpërmjet kredive konsumatore nga “Raiffeisen Bank”.
- Janë përfshirë si shpenzime, pagesat e interesave të kredive konsumatore, si dhe të kredisë për shtëpinë e blerë nga nëna e subjektit (për aq sa janë paguar nga subjekti).
- Janë përfshirë shpenzimet e transportit nga vendbanimi në vendin e punës, sipas deklarimeve të subjektit në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në të cilin ka sqaruar se në shumicën e rasteve ka përdorur transportin publik, duke specifikuar çmimin e biletës dhe se ndonjëherë ka udhëtuar me makinat e kolegëve të saj. Subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime transporti kur ka qenë me lejelindje nga data 10.6.2014 – 2.3.2015, ndërkohë që ka saktësuar shpenzimet mujore të transportit, si vijon:
  - për vitin 2011: shpenzimet mujore në vlerën që varion 1,600 - 3,200 lekë, përveç muajit gusht në vlerën 1,600 lekë për shkak se leja vjetore është kaluar pranë familjes;
  - për vitin 2012: shpenzimet mujore në vlerën që varion 1,600 - 3,200 lekë, përveç muajit gusht në vlerën 1,600 lekë;
  - për vitin 2013: shpenzimet mujore në vlerën që varion 6,400 -7,000 lekë, përveç muajit gusht në vlerën 2,000 lekë;
  - nga janar - maj 2014<sup>104</sup> shpenzimet mujore në vlerën që varion 3,200 - 8,000 lekë/muaj;
  - nga marsi i vitit 2015 dhe në vijim: shpenzimet mujore në vlerën që varion 6,400 - 8,000 lekë, përveç muajit gusht në vlerën 2,000 lekë;
  - çdo shpenzim tjetër është evidentuar nga lëvizjet bankare dhe çdo faturë/mandat administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

### **Pasuritë**

- Janë përfshirë të gjitha pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi dhe bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortit. Në këtë analizë, është përfshirë edhe pasuria apartament e nënës së subjektit, deri sa u vlerësua se nëna dhe vëllezërit e saj ishin persona të tretë të lidhur dhe u analizua mundësia e blerjes së kësaj pasurie.

---

<sup>104</sup>Subjekti ka qenë me lejelindje nga data 10.6.2014 – 2.3.2015, sipas vërtetimit të Gjykatës Përmet, datë 25.1.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare<sup>105</sup> në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.

- Shuma në fund, përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

### **Detyrimet**

- Të gjitha kreditë e marra nga subjekti dhe bashkëshorti, përfshirë edhe kredia e marrë për blerjen e apartamentit të nënës së subjektit në shtator të vitit 2012.

- Huat e mara nga individë/persona të tjerë të lidhur.

Pasuria *neto* është diferenca e pasurisë me detyrimet.

Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total.

Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura (shpenzime + pasuri neto), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

### **Vlerësim përfundimtar në lidhje me kriterin e pasurisë**

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu:

i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016);

ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016);

iii) subjekti nuk ka kryer fshehje pasurie (germa “c”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016);

iv) subjekti nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Për sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas germës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

---

<sup>105</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., nga “Intesa Sanpaolo Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2020, nga “Raiffeisen Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020, nga BKT; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2020, nga “ABI Bank”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2020, nga “Credins Bank”.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta H. Aliu (Paja), i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. \*\*\*, datë 16.2.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu (Paja).

### **Hetimi i Komisionit**

Gjatë hetimit administrativ, me kërkesë të Komisionit, DSIK-ja ka kryer përditësimin e të dhënave dhe me shkresë konfidenciale ka informuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për këtë subjekt nga data 30.10.2017 dhe aktualisht.

Në lidhje me kontakte të mundshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, u verifikuan të dhënat e hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*, nga të cilat ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë udhëtuar me automjetet me targa: \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*, \*\*\*. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka dhënë sqarime mbi pronarët e këtyre automjeteve, marrëdhëniet me ta, si dhe qëllimin e udhëtimeve<sup>106</sup>. Për të gjithë pronarët e deklaruar nga subjekti dhe atë të rezultuar si përdorues apo pronarë referuar të dhënave të policëmbajtësit nga sistemi i AMF-së, është kërkuar informacion mbi çështje të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë këta shtetas, si dhe informacion nga SPAK për përfshirje të tyre në veprimtari të krimit të organizuar, nga ku nuk kanë rezultuar procese gjyqësore apo vendime të dhëna nga gjyqtarja Rezarta Aliu me palë këta shtetas<sup>107</sup>, apo procedime penale të regjistruara në emër të tyre<sup>108</sup>.

Ndërkohë, Komisioni thelloi hetimin administrativ në lidhje me automjetin me targa \*\*\*, për të cilin subjekti ka deklaruar se ka qenë në bashkëpronësi të motrës F. P. (T.) dhe bashkëshortit të saj dhe se me këtë automjet, ata kanë udhëtuar dy herë për vizita turistike më 27.11.2016, në Selanik dhe më 13.8.2017 në O., Maqedoni. Pas verifikimit në sistemin AMF-së, nga të dhënat e policëmbajtësit, ky mjet rezultoi në pronësi të shtetasit B. T. në lidhje me të cilin SPAK<sup>109</sup> informoi se në ngarkim të tij është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, për nenet 78/2, 28/4, 333/a të Kodit Penal. Pas përfundimit të hetimeve, në vitin 2020, është vendosur dërgimi në gjyq i këtij procedimi, në ngarkim të të pandehurit B. T., për nenet 78/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

Nga verifikimi i veprave penale të parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, vërehet se nenet 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal parashikohen në kreun XI të Kodit Penal dhe në këtë kuptim, bazuar në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, shtetasi B. T., duke qenë i proceduar dhe dërguar për gjykim për këto vepra, konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar.

Në shtojcën nr. 3, “deklarata e kontrollit të figurës”, subjektet kanë pasur detyrimin për të deklaruar nëse ndonjë nga anëtarët e familjes (i afërt deri në shkallë të katërt ose krushqi deri

<sup>106</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>107</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet; shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021 nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>108</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

<sup>109</sup> Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

në shkallë të dytë) është i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar. Shtetasi B. T., duke qenë bashkëshort i motrës së subjektit të rivlerësimit, është krushqi e shkallës së dytë. Por, duke qenë se procedimi penal në ngarkim të tij është i vitit 2019, në momentin e dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës për efekt të procesit të rivlerësimit *Vetting*, ky fakt nuk kishte ndodhur dhe për këtë shkak nuk ishte deklaruar nga subjekti.

Për sa i takon kontakteve të subjektit me shtetasin B. T., pas verifikimit në sistemin *TIMS* rezultoi se përveç dy udhëtimeve të evidentuara nga Komisioni gjatë periudhës kur ky shtetas nuk ka qenë i proceduar penalisht, (më 27.11.2016 në Selanik dhe më 13.8.2017, në O. të Maqedoni), nga gushti i viti 2017 deri në vitin 2019 kur ai ishte referuar si person në kërkim, nuk rezultuan udhëtime të subjektit apo bashkëshortit me shtetasin B. T.. Po kështu, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, nuk është evidentuar asnjë rrethanë për t'u marrë parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit me shtetasin B. T., në kuptim të nenit 38 pika 4 e ligjit 84/2016, si dhe nuk ka pasur asnjë të dhënë nga cilido burim i ligjshëm, për kontakte të subjektit a personave të lidhur me të me shtetasin B. T., ashtu sikurse dhe me persona të tjerë të dyshuar apo të proceduar për veprimtari të krimit të organizuar, ekzistenca e të cilave do të penalizonte subjektin e rivlerësimit.

Veç sa më sipër, me kërkesë të Komisionit, në lidhje me çdo lloj procedimi penal në emër të shtetasit B. T., Prokuroria e Përgjithshme<sup>110</sup> përcolli informacionin e ardhur nga prokuroritë e rretheve, sipas të cilit për këtë shtetas nuk rezultuan kallëzime apo procedime penale të regjistruara.

Në përfundim, në lidhje me kontrollin e figurës, nga Komisioni nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës pranë DSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, është e përshtatshme për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës "b", të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Rezarta Aliu (Paja), bazuar në:

**1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale** të subjektit të rivlerësimit, nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2018, të kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, protokolluar nga Komisioni, me nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2018, nga ku rezultoi se subjekti është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, si vijon:

### **Për aftësitë profesionale**

#### *a) Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Rezarta Aliu ka edhe njohuri procedurale civile dhe penale. Në përgjithësi, ndjek me rigorozitet hapat proceduralë gjatë gjykimit, duke disponuar me urdhra dhe vendime të ndërmjetme në funksion të zgjidhjes në themel të çështjes.

#### *b) Arsyetimi ligjor*

---

<sup>110</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.3.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

Gjyqtarja Rezarta Aliu ka aftësi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore përfundimtare, respekton rregullat e drejtshkkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimeve të saj është mesatare nga pikëpamja e organizimit dhe nuk është e standardizuar njësoj në çdo rast.

Vendimet e saj përfundimtare janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit procedural civil apo të legjislacionit procedural penal. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së normës ligjore tek të gjithë konceptet dhe institutet kyçe dhe kur është rasti, për interpretimin e ligjit përdor parime të përgjithshme të së drejtës apo jurisprudencë të gjykatave më të larta. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Vendimet e saj janë gjithëpërfshirëse në raport me kërkimet dhe prapësimet e palëve. Dispozitivi është rrjedhë e pjesës arsyetuese. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### **Për aftësitë organizative**

#### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Rezarta Aliu ka përfunduar gjithsej 225 çështje gjyqësore, nga të cilat 78 çështje penale, 120 çështje civile të përgjithshme, 24 çështje familjare dhe 3 çështje civile të veçanta. Sipas germës “g”, të pikës 3, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, që nuk është e organizuar është pjesë e seksionit të përgjithshëm, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundërvajtje) dhe civile me palë kundërshtarë. Gjyqtarja Rezarta Aliu, gjatë periudhës qershor 2014 – shkurt 2015 nuk është paraqitur në detyrë për shkak të lejes së lindjes. Rrjedhimisht, ky rregull në rastin e saj nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 400 gjykime çështjesh të tilla. Duke iu referuar të dhënave statistikore të gjyqtarës Rezarta Aliu konstatohet se ka pasur ngarkesë sasiore nën standardin minimal sasior. Në kohëzgjatjen e gjykimit ka gjykuar çështjet brenda afateve ligjore apo standarde, ndërsa ka treguar kujdes edhe për arsyetimin në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore.

#### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Ka mbikëqyrur aktet e njoftimit, për të shmangur pengesat lidhur me to. Gjyqtarja i kushton rëndësi edhe caktimit të seancave vijuese në gjykim, ku zbaton parimin e shpejtësisë në gjykim, duke i caktuar seancat edhe të nesërmen nëse shkak i shtyrjes së saj e lejon një gjë të tillë. Një tipar pozitiv i punës së saj është zhvillimi i gjykimeve gjithmonë në sallë dhe regjistrimi i seancave me sistemin audio në funksion të transparencës dhe solemnitetit. Gjyqtarja Rezarta Aliu zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në dhënien e vendimit përfundimtar. Në të gjitha rastet, disponon me vendime të ndërmjetme e me shkak ligjor për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit.

#### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

Gjyqtarja ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Rregullshmëria e saj në këtë aspekt bie në sy edhe nga teknika, me të cilën ka paraqitur

Formularin e Vetëvlerësimit dhe dokumentet, të cilat janë lidhur së bashku në mënyrë të qartë dhe estetike.

### **Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

Nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Rezarta Aliu. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për të është paraqitur vetëm 1 ankesë në vitin 2014, e cila është verifikuar për zvarritje dhe në përfundim, i është regjistruar gjyqtarës për vlerësim profesional dhe etik. Ndaj saj nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe nuk është dhënë ndonjë masë disiplinore.

#### *b) Integriteti*

Për subjektin Rezarta Aliu, nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *c) Paanësia*

Për subjektin nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Gjithashtu, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse si në seancat përgatitore ashtu edhe në seancat gjyqësore, ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

#### *b) Aftësia për të bashkëpunuar*

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Rezarta Aliu për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### *c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

Subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ka marrë pjesë në 24 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Këto të dhëna tregojnë se ka marrë pjesë në 39 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Gjatë periudhës së rivlerësimit nuk dokumentohet që gjyqtarja Rezarta Aliu të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale jashtë Shkollës së Magjistraturës.

## **2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:**

**2.1.** Informacioni i marrë nga tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLD-ja në raportin e saj.

**2.2.** Informacioni i marrë nga tetë denoncime<sup>111</sup> të publikut, nga verifikimi i të cilave Komisioni kreu hetime shtesë dhe kërkoi shpjegime nga subjekti për pesë prej tyre, si vijon:

**2.2.1.** Denoncim nga shtetasi H. D.

Ky shtetas ngrinte pretendime për zvarritje të gjykimit të çështjes nga gjyqtarja Rezarta Aliu, e cila pas një maratone të gjatë seancash e kishte nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit, duke e çuar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Denoncuesi ka paraqitur bashkëngjitur, vendimin nr. \*\*\*, datë 30.1.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, “mbi shpalljen e moskompetencës lëndore”, në të cilin gjyqtarja Rezarta Aliu ka arsyetuar se çështja në fjalë përbën një mosmarrëveshje civile dhe, për këtë arsye, mungon kompetenca lëndore për shqyrtimin e kësaj padie nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit për zvarritje të gjykimit, duke vënë në dispozicion procesverbalet e seancave gjyqësore.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se nuk ka pasur asnjë shtyrje seance pa shkaqe të arsyeshme dhe as zvarritje të gjykimit me keqdashje, siç pretendohet nga denoncuesi. Subjekti ka sqaruar se janë zhvilluar gjithsej katër seanca veprimesh përgatitore me praninë e palëve, të cilat janë shtyrë për marrjen e provave të kërkuara nga palët dhe për t’i dhënë kohë të njihen me këto prova. Madje, dy seanca janë shtyrë me kërkesën e shtetasit H. D..

Më tej, subjekti ka sqaruar se vendimi i moskompetencës lëndore, prej saj si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, është dhënë në datën 30.1.2019, ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2019, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin se është gjë e gjykuar dhe ka gjobitur palën paditëse për padi abuzive kush? gjykata. Sipas saj, në rrethanat kur ndaj të paditurit H. D. është marrë një vendim pozitiv dhe në favorin e tij, mbetet i paqartë shkaku i ankesës ndaj saj si gjyqtare pas më shumë se një vit e gjysmë nga dhënia e vendimit, si dhe gati pas një viti kur Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur në favor të tij. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur akte të njehsuara me origjinalin të dosjes nr. \*\*\* regj, datë regjistrimi 10.7.2018, që i përket paditësit F. H. kundër të paditurit H. D..

Përveç sa më sipër, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit se në periudhën qershor 2018 – 2019, periudhë të cilës i përket edhe çështja objekt shqyrtimi, ka gjykuar njëkohësisht në katër gjykata, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore Gjirokastrë dhe Sarandë. Për të mbështetur këtë pretendim subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 13.6.2018, të KLD-së “Mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata”, dy tabela me numrin e çështjeve të caktuara për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si dhe urdhrat e brendshëm nr.

---

<sup>111</sup> Shihni denoncim nga një grup juristësh protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020; denoncim nga H. D. përcjellë nga SPAK, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020; denoncim nga L. M. përcjellë nga Komisioneri Publik, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020; denoncim nga A. S., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017; denoncim nga AMBU, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot, datë 5.8.2019; denoncim nga A. S., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2020; ankim nga L. G., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 27.9.2019; denoncim nga P. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2018, në dosjen e Komisionit.

\*\*\* prot., datë 25.6.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2018, të Kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale nr. \*\*\* Regj, datë regjistrimi 10.7.2018, konkretisht, procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara me praninë e palëve, të cilat i përkasin datave 27.11.2018, 19.12.2018, 16.1.2019 dhe 30.01.2019, konstatohet se pretendimet e denoncuesit për seanca maratonë nuk qëndrojnë, pasi janë zhvilluar vetëm katër seanca veprimesh përgatitore me praninë e palëve.

Për sa i takon shkaqeve të shtyrjes së seancave gjyqësore konstatohet se ato kanë qenë, si vijojnë: (i) seanca gjyqësore e datës 27.11.2018 është shtyrë për shkak të kërkesës së palës paditëse për marrje provash të reja, konkretisht është kërkuar informacion shkresor nga ZVRPP-ja Durrës, lidhur me praktikën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; (ii) seanca gjyqësore e datës 19.12.2018 është shtyrë për shkak të kërkesës së palës paditëse për marrje provash të reja, konkretisht është kërkuar informacion shkresor nga ZVRPP-ja Durrës, lidhur me ekzekutimin ose jo të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.4.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës; (iii) seanca gjyqësore e datës 16.1.2019 është shtyrë me qëllim për t'i dhënë kohë palës së paditur të njihet me provat shkresore të depozituara nga pala e paditur. Pra, siç vërehet shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore janë të diktuar nga shkaqe të arsyeshme, pasi marrja e këtyre provave të reja ishte e domosdoshme për zgjidhjen e konfliktit ligjor dhe, për pasojë, kryerjen e një procesi të rregullt ligjor. Megjithatë, pavarësisht shkaqeve të arsyeshme të shtyrjes, konstatohet se seancat gjyqësore janë caktuar nga gjyqtarja me afat më të gjatë se 15 ditë nga njëra-tjetra, çka ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit në tërësi.

Për sa i takon kohëzgjatjes së çështjes, nga data e regjistrimit më 10.7.2018 dhe deri në datën e dhënies së vendimit më 30.1.2019, konstatohet se çështja ka zgjatur 6 muaj e 20 ditë. Ligji nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", nuk parashikon ndonjë afat konkret nga data e regjistrimit të çështjes deri në dhënien e vendimit, por në nenin 3 të tij si parim të përgjithshëm sanksionon gjykimin brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, por pa sanksionuar afat maksimal për gjykimin e çështjeve. Në rastin konkret nga shqyrtimi i akteve në dosje, konstatohet se në këtë kohëzgjatje kanë ndikuar edhe zhvillimi i seancave gjyqësore me afat më shumë se 15 ditë nga njëra-tjetra.

Ndërsa, lidhur me ngarkesën e subjektit, në periudhën në fjalë, nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura prej saj vërtetohet se subjekti, përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka gjykuar njëkohësisht edhe në tre gjykata të tjera, çka dëshmon ngarkesë në punë të subjektit të rivlerësimit.

Në procesin e vendimmarrjes, lidhur me këtë çështje, Komisioni vlerësoi se referuar të gjitha sa janë parashtruar dhe vërtetuar nga subjekti në ushtrim të barrës së provës, kohëzgjatja e gjykimit të çështjes nuk ka ardhur për shkaqe objektive dhe të pajustificuara dhe, për më tepër, nuk ka cenuar të drejtat e palëve në proces. Po kështu, Komisioni i është referuar edhe vendimit nr. 5, datë 12.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku përcaktohet se: "... pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund ti pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë; kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e



*gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushtrojë detyrën e tij, etj.”.*

### **2.2.2. Denoncim nga shtetasja L. M.**

Kjo shtetase ngrinte pretendime ndaj gjyqtares Rezarta Aliu, për konflikt interesi, zvarritje të gjykimit dhe mosnjohje me aktet e dosjes. Sipas saj gjyqtarja duhet të ishte dorëhequr nga çështja, pasi avokat i palës së paditur ka qenë shtetasi R. A., vjehri i gjyqtares.

Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të denoncueses, u administrua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës<sup>112</sup>, dosja gjyqësore e çështjes nr. \*\*\*, e regjistruar në datën 4.9.2019, me palë ndërgjyqëse, paditës B. A. dhe të paditur shoqëria “P.” sh.p.k., etj., me objekt “shfuqizimin e lejes së ndërtimit nr. \*\*\*, datë 24.6.2019, etj.”, nga aktet e së cilës u konstatua se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 4.9.2019 dhe po gjykohet nga gjyqtarja Rezarta Aliu.

Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton që përfaqësues i palës së paditur, shoqëria “P.” sh.p.k. të ketë qenë shtetasi R. A., ndërkohë që për çështjen janë zhvilluar gjithësej 14 seanca gjyqësore dhe referuar informacionit mbi çështjen, ajo vijon të jetë ende në shqyrtim. Për këtë arsye, referuar jurisprudencës së KPA-së<sup>113</sup>, sipas së cilit: “.....parashikimi kushtetues që vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, do të zbatohet ndaj atyre çështjeve të cilat janë në shqyrtim në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit që po i nënshtrohet procesit të rivlerësimit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative ...”, në rastin në fjalë, duke qenë se çështja është në shqyrtim e sipër nga subjekti Rezarta Aliu, nuk mund të jetë objekt vlerësimi nga Komisioni.

### **2.2.3. Denoncim nga shtetasi A. S.**

Kjo shtetase ngrinte pretendime për vendimmarrje të padrejtë të subjektit të rivlerësimit, pasi sipas saj, gjyqtarja i ka dhënë të drejtën e kujdestarisë së fëmijës, njerks dhe jo nënës (denoncueses), ndërkohë që fëmija, pasi është pyetur nga gjyqtarja dhe psikologja, është shprehur se do të rrijë me nënën. Po ashtu, denoncuesja pretendonte se gjyqtarja i ka mohuar të drejtën e fjalës gjatë procesit gjyqësor dhe se është fyer prej saj.

Pas shqyrtimit të këtij denoncimi, për sa i takon pretendimit të parë të denoncueses, konstatohet se është një pretendim që ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit dhe në këtë kuptim vlerësohet se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

Për sa i takon pretendimit mbi sjelljen e subjektit gjatë gjykimit të çështjes, nga Komisioni u administruan nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet<sup>114</sup>, procesverbalet e seancave gjyqësore të dosjes civile nr. \*\*\*, datë 5.12.2017, si dhe CD e regjistrimeve audio, nga verifikimi i të cilave u konstatua se komunikimi i gjyqtares gjatë procesit ka qenë korrekt dhe brenda etikës.

### **2.2.4. Denoncim nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore**

Ky institucion, së pari, ngrinte pretendime për vendimmarrje të padrejtë të gjyqtares Rezarta Aliu, duke parashtruar se gjyqtarja ka cenuar rëndë interesin publik, pasi nëpërmjet vendimeve të saj i është dhënë e drejta subjekteve paditëse të shfrytëzojnë pa kriter shtratin e lumit

<sup>112</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>113</sup> Shihni vendimin nr. \*\*\*, datë 23.10.2020, të KPA-së.

<sup>114</sup> Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2021, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe dokumentet bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

Shkumbin për nxjerrjen e materialeve inerte. Së dyti, pretendohet se dosjet gjyqësore të vendimeve nr. \*\*\*, n. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, datë 15.11.2018, të gjyqtarës Rezarta Paja (Aliu) nuk janë përcjellë pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, çka e ka rënduar, më tej, interesin publik, duke sjellë pasoja të rënda në publik.

Pas shqyrtimit të këtij denoncimi, sa i takon pretendimit të parë, konstatohet se është një pretendim që ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit, e në këtë kuptim vlerësohet se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

Për sa i takon pretendimit të dytë, lidhur me përcjelljen e dosjeve me vonesë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, gjatë hetimit administrativ, Komisioni i kërkoi sqarime subjektit, e cila sqaroi se<sup>115</sup> referuar neneve 39 dhe 43, të ligjit nr. 98/2016, “për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në mungesë të një rregullore të brendshme të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pas dorëzimit të dosjes në kryesekretari, gjyqtari nuk kryen dhe as mbikëqyr veprimet që kryhen me to, pasi dërgimi i dosjeve në Gjykatën e Apelit dhe i gjithë procesi i administrimit të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor kryhet nga ana e kryesekretarit, nën mbikëqyrjen e kancelarit. Subjekti ka informuar se prej saj dorëzimi i dosjeve të vendimeve të mësipërme në kryesekretari është bërë brenda afatit ligjor, si dosjet e vendimeve të themelit ashtu edhe ato mbi shqyrtimin e ankimeve të veçanta të palës ankuese.

Sipas saj, arsyet e vonesës së dërgimit të dosjeve të vendimeve nr. \*\*\*, datë 21.1.2019, nr. \*\*\*, datë 4.2.2019 dhe nr. \*\*\*, datë 4.2.2019, kanë të bëjnë me pamundësinë e njoftimit të vendimeve të mospranimit të ankimeve të veçanta palës ankuese, pasi rezulton të jetë bërë ndryshimi i adresës së saj nga Elbasan, në S., Fier.

Ndërsa, për sa i takon dosjeve të vendimeve nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, nr. \*\*\*, datë 15.11.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, të mara nga subjekti nuk janë dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi ndaj zgjidhjes së çështjes në themel nëpërmjet tyre nuk është paraqitur ankim nga palët ndërgjyqëse, si dhe ndaj ankimeve të veçanta është vendosur mospranim ankimi.

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur:

- shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2021, drejtuar kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në të cilën kërkohet informacion mbi datat e përcjelljes së dosjeve lidhur me çështjet e përfunduara nga subjekti me vendimet nr. \*\*\*, nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, si dhe regjistrimit të këtyre çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë;

- shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2021, nga kancelarja e gjykatës, në të cilën informon se: (i) nga ana e Këshillit të Baseni Ujor, Shkumbin janë paraqitur vetëm ankime të veçanta, për secilin nga vendimet nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, nr. \*\*\*, datë 15.11.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, për të cilat subjekti ka vendosur përkatësisht me vendimet nr. \*\*\*, datë 21.1.2019, vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2019 dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2019, mospranimin e ankimeve; (ii) ndaj këtyre vendimeve për mospranim ankimi i veçantë nga pala ankuese është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, duke u dërguar edhe dosjet përkatëse në këtë gjykatë në datën 16.10.2019, vërtetuar me shkresat nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* prot., si dhe nr. \*\*\* regjistri, bashkëngjitur shkresës;

- shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2019, drejtuar KLGj-së dhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, sipas të cilës njoftimet e vendimeve të mospranimit të

<sup>115</sup> Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

ankimeve të veçanta palës ankuese janë bërë dy herë, pasi është bërë ndryshimi i adresës së saj nga Elbasan, në S., Fier.

Nga sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe aktet e vëna në dispozicion, vlerësohet se pretendimi i ngritur në denoncimin e Agjencisë së Burimeve Ujore, lidhur me përcjelljen me vonesë të dosjeve, nuk qëndron, pasi referuar nenit 48 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” me titull “ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit”, përcaktohet se: “Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit”. Në rastin konkret, nuk ka ankim ndaj vendimeve përfundimtare, rrjedhimisht as vendim gjyqtari për pranimin e ankimit, si dhe ndaj ankimeve të veçanta është vendosur mospranim ankimi, prandaj dosjet e vendimeve nr. \*\*\*, datë 30.10.2018, nr. \*\*\*, datë 15.11.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, të dhëna nga subjekti nuk janë dërguar në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndërsa, për sa i takon vonesës së dërgimit të dosjeve të vendimeve të mospranimit të ankimeve të veçanta kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimit të adresës së palës ankuese.

Përveç sa më sipër, në vështrim të neneve 39 dhe 43, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, dërgimi i dosjeve në Gjykatën e Apelit dhe i gjithë procesi i administrimit të ankimit ndaj një vendimi gjyqësor kryhet nga ana e sekretarisë dhe kancelarit dhe jo nga gjyqtari.

### **2.2.5. Denoncim nga shtetasit P. K.<sup>116</sup>**

Ky shtetas denonconte gjyqtaren Rezarta Aliu, për zvarritje të procesit gjyqësor, që i përket çështjes së tij të pronësisë e cila po zgjat prej 10 vjetësh. Nga dokumentet bashkëngjitur denoncimit, u konstatua se në lidhje me këtë çështje, denoncuesi ka bërë ankesë edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila pas trajtimit të saj ka konstatuar se: “Çështja objekt ankese vijon të jetë në proces gjykimi që nga data 24.4.2015, pra, për një periudhë tërësore kohore prej tre vjetësh dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar”. Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, është konstatuar se kohëzgjatja e shqyrtimit të kësaj çështjeje nga data e marrjes në dorëzim për rigjykim nga gjyqtarja Rezarta Aliu më 30.5.2017, deri në datën 6.6.2018, kur është caktuar seanca e ardhshme gjyqësore, vijon prej një afati kohor prej rreth një viti dhe çështja është akoma në proces, gjë që bie në kundërshtim me vendimin e KLD-së nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” i ndryshuar”.

Në përfundim, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë është konstatuar se: “Ka vend për verifikim të pretendimeve të paraqitura nga ankuesi lidhur me zvarritjen e gjykimit të kësaj çështjeje. Nisur nga fakti se i vetmi mekanizëm inspektues në këtë periudhë tranzitore sipas nenit 150/5 të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ është ILD-ja, kjo ankesë i është përcjellë këtij institucioni”.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime mbi pretendimin për zvarritje dhe ecurinë e mëtejshme të procesit gjyqësor.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

Në parashtrimet e saj, subjekti duke përshkruar në mënyrë të detajuar 20 seancat gjyqësore të zhvilluara prej saj, ka deklaruar se shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore kanë qenë gjithmonë të ligjshme dhe në funksion të zhvillimit të një gjykimi sipas Kodit të Procedurës

<sup>116</sup> Shihni denoncim nga P. K., protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2018, në dosjen e Komisionit.

Civile. Sipas saj gjykimi është shtyrë për shkak të mosmarrjes dijeni rregullisht të palëve, çka do të përbënte shkak për prishjen e vendimit nga një gjykatë më e lartë. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur procesverbalet e përmbledhura të seancave gjyqësore të mbajtura nga sekretaria gjyqësore.

Përveç sa më sipër, subjekti sjell në vëmendje të Komisionit se në periudhën qershor 2018 – 2019, periudhë të cilës i përket edhe çështja objekt shqyrtimi, ka gjykuar njëkohësisht në katër gjykata, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe në gjykatat e rretheve gjyqësore Gjirokastër dhe Sarandë. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti ka paraqitur: vendimin nr. \*\*\*, datë 13.6.2018, të KLD-së “Mbi transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve në disa gjykata”; dy tabela me numrin e çështjeve të caktuara për gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës; urdhrat e brendshëm nr. \*\*\* prot., datë 25.6.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2018, të Kryetares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Nga dokumentet e administruara, në lidhje me këtë denoncim dhe procesverbalet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, u konstatua se çështja objekt shqyrtimi është regjistruar për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë në datën 30.5.2017 dhe i ka kaluar gjyqtarës Rezarta Aliu (Paja), e cila ka caktuar zhvillimin e seancës përgatitore më 14.6.2017. Ndërsa në datën 5.2.2019, ajo i ka paraqitur zv/kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi për shkak të marrjes së një mesazhi telefonik me përmbajtje kërcënuese lidhur me këtë gjykim. Kjo kërkesë është pranuar nga zv/kryetari i gjykatës në datën 12.2.2019. Pra, siç vërehet nga momenti i regjistrimit për rigjykim dhe deri në datën e pranimit të dorëheqjes kohëzgjatja e çështjes ka qenë 1 vit e 8 muaj, pra, në kundërshtim me vendimin e KLD-së nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” i ndryshuar.

Për sa i takon afatit të caktimit të seancave gjyqësore, konstatohet se subjekti jo në çdo rast ka respektuar afatin 15-ditor parashikuar në Kodin e Procedurës Civile dhe legjislacionin për gjykatat administrative. Për sa i takon shkaqeve të shtyrjes vërehet se përgjithësisht janë për shkaqe të arsyeshme objektive që kanë ndikuar në moszhvillimin e gjyqit, të cilat kanë lidhje me mosformimin e trupit gjykues, mosmarrjen dijeni të palëve për shkak të adresave të pasakta, e së fundi, paraqiten e dorëheqjes nga subjekti për shkak të marrjes së një mesazhi kërcënues lidhur me çështjen.

Ndërsa, lidhur me ngarkesën e subjektit në punë, në periudhën në fjalë, nga verifikimi i dokumenteve vërtetohet se subjekti, përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka gjykuar njëkohësisht edhe në tri gjykata të tjera, çka dëshmon ngarkesë të lartë në punë të subjektit të rivlerësimit, por edhe harxhimin e një kohe fizike për shkak të udhëtimeve në katër qytete.

Në konkluzion të vlerësimit të kësaj çështjeje nga Komisioni, në vlerësim të të gjitha rrethanave dhe provave që subjekti paraqiti, nuk është vërtetuar që tejkalimi i afateve të gjyqimit të ketë ndodhur për shkaqe të pajustificuara objektivisht dhe ligjërish nga subjekti, apo të jetë kryer me qëllim cenimin e të drejtave të palëve në proces dhe, si i tillë, nuk mund të përbejë shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 12.12.2013<sup>117</sup>,

---

<sup>117</sup> “pavarësisht afateve të parashikuara në ligjet tona procedurale, qofshin ato civile dhe penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë dhe janë të ndërgjegjshme se jo gjithmonë këto afate mund të zbatohen me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre dhe jo gjithmonë mosrespektimi i tyre është shkak ligjor për marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve nga ana e KLD-së. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se pamundësia për të respektuar maksimalisht këto dispozita mund të justifikohet nga ekzistenca e shkaqeve objektive, të cilat nuk varen nga gjyqtarët dhe që mund ti pengojnë në respektimin rigoroz të këtyre normave, siç mund të jenë ngarkesa e madhe në punë; kompleksiteti i çështjeve në ngarkim; sjellja e palëve gjatë procesit; pamundësia objektive e gjykatave për zhvillimin e procesit gjyqësor, shkaqe të justifikuara shëndetësore apo familjare, të cilat mund të kenë ndikim direkt tek gjyqtari dhe nuk e lejojnë atë të ushrojë detyrën e tij, etj.”

i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë parashikon një qëndrim, i cili është mbajtur edhe nga KPA<sup>118</sup>.

**3. Informacioni i marrë nga burimet arkivore të KLD-së, lidhur me ankesa, kallëzime apo masa disiplinore, nga ku për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, përgjatë periudhës së rivlerësimit rezultoi se: (i) nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore; (ii) një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik.**

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi nga KLGJ-ja<sup>119</sup> praktikë ankesën e shtetasës E. R. me nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2014, në të cilën ngriheshin pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës Rezarta Aliu, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për zvarritje të gjykimit, në shqyrtimin e çështjes civile me kërkuar S. R., me objekt “rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit nr. \*\*\*, datë 11.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Nga aktet e kësaj praktikë ankese rezultoi se në datën e verifikimit më 29.5.2014, nga KLD-ja, kjo çështje ishte në gjykim dhe se deri në atë moment ishin zhvilluar pesë seanca gjyqësore. Ndërsa, gjykimi i kësaj çështje nga data e shortit më 27.1.2014, deri në datën e kontrollit më 29.5.2014, ka zgjatur 4 muaj e 2 ditë, ndërkohë që çështja është rihedhur në short dhe i ka rënë një tjetër gjyqtari që më pas ka vijuar gjykimin. Në përfundim të verifikimit, nga ana e inspektorëve të KLD-së është konstatuar se gjyqtarja Rezarta Aliu ka tejkalar afatin e parashikuar nga neni 5, germa “j”, e vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, ku afati i parashikuar në këto kategori çështjesh është dy muaj. Sipas KLD-së është e qartë se gjyqtarja nuk e ka menaxhuar mirë gjykimin dhe ka tejkalar afatin 2-mujor të përcaktuar nga KLD-ja. Në përfundim, çështja civile me nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2014, nga KLD-ja i është evidentuar gjyqtarës Rezarta Aliu si çështje e zgjidhur tej afatit standard të përcaktuar prej saj, për t’u përdorur në rastin e vlerësimit etik dhe profesional të saj.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi kohëzgjatjen e kësaj çështjeje në tejkallim të afatit 2-mujor të parashikuar nga neni 5, germa “j”, e vendimit të KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Lidhur me këtë çështje, në parashtrimet e saj, subjekti ka sqaruar se gjykimi është shtyrë pikërisht për shkak të mosmarrjes dijeni rregullisht të palëve, çka do të përbënte shkak për prishjen e vendimit nga një gjykatë më e lartë, duke qenë se personat e tretë nuk ishin banorë të Përmetit, por banorë të Pogradecit dhe Tiranës dhe, si të tilla, afatet e njoftimit të tyre nuk mund të ishin të shkurtra. Përveç kësaj ajo ka deklaruar se nuk është vënë në dijeni nga Inspektorati i KLD-së as për verifikimin dhe as për rezultatet e përfundimit të këtij verifikimi. Për të mbështetur pretendimet e saj subjekti ka paraqitur akte të dosjes me nr. 3, datë regjistrimi 5.2.2014, që i përket kërkuar Sokol Riska, të njehsuara me origjinalin.

Nga verifikimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se shtyrja e seancave gjyqësore kanë qenë për shkak të mosmarrjes dijeni rregullisht të palëve, pra, për shkaqe të justifikuara dhe, për këtë arsye, tejkallimi i afateve në gjykim nuk mund të përbejë shkak që cenon aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**3. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”**

<sup>118</sup> Shihni nr. 21, datë 13.09.2019, të KPA-së për subjektin Gentian Medja.

<sup>119</sup> Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2021, nga KLGJ-ja në dosjen e Komisionit.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni vlerësoi se:

- i) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016;
- ii) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Sa i takon tri çështjeve për të cilat u evidentuan tejkalime të afateve të gjykimit, analizuar në mënyrë specifike si më sipër në këtë vendim, Komisioni iu referua vendimit nr. 69, datë 17.11.2015 dhe vendimit nr. 1, datë 21.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilëve: *“Kohëzgjatja e arsyeshme e procesit gjyqësor, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuar, dhe autoriteteve përkatëse”* dhe në përfundim, krijoi bindjen se zgjatja e afateve në çdo rast, nuk ka qenë për faj apo neglizhencë të subjektit të rivlerësimit, por ka ndodhur për shkaqe objektive e te përligjura. Në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk është bërë shkak me veprimet apo mosveprimet e tij për tejkalimet e afateve të gjykimit dhe për më tepër, nuk u vërtetua që këto tejkalime të kenë qenë të qëllimshme, por ato kanë ardhur për shkaqe të pavarura prej tij, si dhe për shkak të kompleksitetit të çështjeve, rrethanë e cila vlerësohet proporcionalisht në raport edhe me treguesit e tjerë brenda kriterit të aftësive organizative, sikurse ngarkesa në punë, pasi në dy raste subjekti përveç Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, ka gjykuar njëkohësisht edhe në tri gjykata të tjera, çka dëshmon ngarkesë të lartë në punë.
- iii) subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- iv) subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **III. SEANCA DËGJIMORE**

Në datën 21.4.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, në përfundim të së cilës, kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, shpalli këtë vendim sot, në datën 22.4.2021, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

### **IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancës dëgjimore.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar, duke paraqitur në çdo rast dokumente shkresore për të vërtetuar për sa i është kërkuar nga Komisioni, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Rezarta Aliu, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.4.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES** **Suela ZHEGU/ Kryesuese**

**Firdes SHULI/ Relatore**

**Brunilda BEKTESHI/ Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Orjanda Liçi*